



KONTROLI I LARTË I SHËTËTIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E  
PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-  
SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA  
2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**PËRPUTHSHMËRISË EKONOMIKO-FINANCIARE**

**NË**

**“DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE**

**KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS**

**BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR**

**FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË**

**KANALIZIMIT NË VLORË, FAZA II”**

**TETOR 2019**



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

<b>Përmbajtja</b>	<b>faqe</b>
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
II. HYRJA .....	8
a. Titulli.....	8
b. Marrësi .....	8
c. Objektivat dhe qëllimi.....	8
d. Identifikimi i çështjes:.....	9
e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim .....	9
f. Përgjegjësitë e audituesve.....	9
g. Kriteret e vlerësimit .....	10
h. Standardet e auditimit .....	11
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT .....	11
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET .....	12
1. Kuadri ligjor i miratuar në lidhje me përfitimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadrin e implementimit të fondeve IPA 2012 si dhe ndryshimet e tij gjatë implementimit. Përfitimet e institucionit referuar kontratave të miratuara për përfituesin (listimeve të miratuara).....	12
2. Prokurimi i fondeve si dhe ndjekja e procedurave të vlerësimit dhe kontraktimit. ....	15
3. Mbi zbatimin e kontratave lidhur me projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë , Faza II” të komponentit III “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”. .....	17
4. Komunikimet zyrtare në lidhje me përfitimet konkrete, opinionet e dhëna për draft raportet e paraqitura nga menaxhimi i projektit, apo dakordësitë mbi to. Marrja në dorëzim e përfitimeve konform kuadrit rregullator në fuqi, regjistrimet kontabël në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare në vitet koherente të përfitimit. Efektiviteti i përfitimeve konkrete, krahasuar me objektivat kryesorë të përcaktuara në kuadër të implementimit të IPA 2012 për përfituesin .....	32
V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT .....	53



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **I.A. PËRSHKRIM I PROJEKTIT TË AUDITIMIT.**

Në bazë të Vendimit për Implementim të Komisionit Evropian me nr. C(2012) 8208, datë 09.11.2012 *“Për adoptimin e një programi kombëtar për Shqipërinë nën IPA – Komponenti Asistenca për tranzicionin dhe Ndërtimi i Institucioneve për vitin 2012”*, është parashikuar dhënia e një kontributi nga Bashkimi Evropian në total në shumën 81,640,000 €. Pas Vendimit të Komisionit Evropian dhe Marrëveshjes së Financimit të lidhur mes Këshillit të Ministrave të Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Evropian më 13 Dhjetor 2012, palët e mësipërme miratuan Programin Kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e komponentit IPA *‘Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional’* për vitin 2012 i parashikuar për tu zbatuar nga Komisioni në mënyrë të centralizuar. Programi me nr. 2012/23-036 (CRIS) është titulluar *“Programi Kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e Komponentit IPA ‘Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional’”*. Kjo marrëveshje financimi është amenduar 2 herë dhe sipas amendimit të dytë me nr. C(2015) 5260 të datës 22.07.2015 është lidhur Marrëveshja e Financimit në zbatim të këtij Vendimi sipas të cilës është rënë dakord mes palëve se: *“Përfituesi ka kapacitete administrative të zhvilluara mjaftueshëm për të lejuar zbatimin e decentralizuar të programeve vjetore nën kuadrin e komponentit IPA - Asistenca e Tranzicionit dhe Mbështetja Institucionale”*. Në kushte të tilla, përfituesit i është dhënë mundësia për të vijuar menaxhimin e fondeve në mënyrë të decentralizuar (për një pjesë të projekteve).

Në vijim të kësaj marrëveshjeje të përgjithshme për Komponentin 1, në qershor 2016, në mënyrë specifike për kontratën e punimeve *“Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë , Faza II”*, është lidhur një tjetër Marrëveshje Operacionale mes z. M. S., Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Financimit dhe Kontraktimit të Fondeve të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë, në rolin e Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO) në cilësinë e ‘punëdhënësit’, z. K. K., përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO) si dhe z. A. A., Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime, në cilësinë e ‘përfituesit’. Sipas kësaj marrëveshjeje përcaktohet se:

*CFCU – është përgjegjëse për tenderimin, kontraktimin, kontabilizimin, pagesat dhe raportimin e kontratave të fondeve të BE – së;*

Sipas Projekt fishës së amendamentit nr. 2 të marrëveshjes së financimit janë përcaktuar shumat si më poshtë:

- **Kostoja totale e Projektit (PA TVSh)** – 21,200,000 €;
- **Kontributi i Bashkimit Evropian** – 18,500,000 €;
- **Mënyra e menaxhimit** – E decentralizuar;
- **Agjencia e Implementimit** – Njësia e CFCU, zinj. A. B. ish – Drejtore e Përgjithshme e CFCU, në rolin e PAO (Nëpunës Autorizues i Programit);
- **Menaxhimi i Implementimit:**
  - a. znj. A. T., Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Integritimit dhe Koordinimit e projekteve IPA, në rolin e SPO (Nëpunës i Lartë Autorizues);
  - b. z. A. A., Drejtor i Përgjithshëm i DPUK;
  - c. z. A. A., Koordinator i projekteve IPA në DPUK;

Ky projekt ka synuar në vetvete të ulë ndotjen e ujit, të përmirësojë kushtet e jetesës dhe të shëndetit për popullsinë e Bashkisë së Vlorës si dhe të përmirësojë kushtet për zhvillimin e



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

rajonit përmes zgjerimit të rrjetit të kanalizimit dhe rehabilitimit të impiantit ekzistues të ujërave të ndotura. Në fund të projektit pjesa më e madhe e Bashkisë Vlorë duhet të jetë lidhur me rrjetin e kanalizimit dhe pjesa më e madhe e ujërave të ndotur do të trajtohet në impiant përpara shkarkimit të tij tek vepra marrëse. Implementimi i këtij projekti vjen si një zbatim i çështjeve të miratuara si prioritete nga Strategjia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime për Shqipërinë, miratuar me VKM nr. 342 datë 12.03.2008 në të cilën janë theksuar këto dy pika:

- 1.b *“Rritja e lidhjeve të popullsisë urbane dhe rurale me rrjetin mbledhës të kanalizimeve”;*  
1.d *“Rriza e % së popullsisë së lidhur me rrjetin mbledhës të kanalizimeve direkt me impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura”.*

Konkretisht ky projekt pjesë e IPA 2012 parashikon:

- të vazhdojë ndërtimin e rrjetit të kanalizimit për të mbuluar të gjithë qytetin e Vlorës (vazhdimin e punimeve të nisura me IPA 2009);
- të rehabilitojë impiantin ekzistues të trajtimit të ujërave të ndotura në gjendjen e tij fillestare të projektuar dhe ta zgjasë atë deri në pikën e menaxhimit të materialit;
- të mundësoje operimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura dhe rrjetit nga kontraktori i punimeve për 2 vite pas përfundimit të tij duke përfshirë trajnimin e stafit të Ujësjellës Kanalizime Vlorë;
- të furnizojë pajisjet laboratorike si dhe makineritë dhe mjetet e nevojshme për operimin dhe mirëmbajtjen e impiantit dhe të gjithë infrastrukturës së rrjetit të kanalizimeve;
- të mundësojë shërbime supervizimi gjatë ndërtimit, gjatë periudhës së defekteve dhe gjatë periudhës funksionale dy vjeçare;
- të mundësojë asistencë teknike për të mbështetur implementimin e planit të veprimit të kapitullit 2.6;

Rezultatet e pritura nga ky projekt janë si më poshtë:

### **Aktiviteti 1 – Punimet**

#### Rezultati 1

1. Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura është rehabilituar sipas gjendjes së tij origjinale të projektuar;
2. Njësia e menaxhimit të materialeve është ndërtuar;
3. Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura është duke operuar në gjendje të qëndrueshme;
4. Stafi i Ujësjellës Kanalizime Vlorë është trajnuar se si të operojë rrjetin e sistemit të kanalizimit;
5. Sipërfaqja brenda kufijve administrativë të Bashkisë Vlorë të jetë mbuluar me rrjetin përkatës të kanalizimit, duke përfshirë zonën që strehon pusët e ujit të pijshëm që furnizojnë popullatën;
6. Uji i ndotur i mbledhur nga rrjeti i kanalizimit brenda kufijve administrativë të Bashkisë Vlorë trajtohet në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura

### **Aktiviteti 2 – Supervizimi**

#### Rezultati 2

1. Punimet e kontratave brenda projektit janë implementuar në cilësi të mirë, në kohë dhe plotësisht në linjë dhe rregullat përkatëse teknike dhe specififikimet;

### **Aktiviteti 4 – Asistenca Teknike**

#### Rezultati 4

1. Qëndrueshmëria e operacioneve dhe mirëmbajtja janë të mbështetura;

Tabela e treguesit të buxhetit nën IPA 2012 paraqitet si më poshtë:





**KONTROLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
				maksimizimin e përfitimit nga Shteti Shqiptar prej këtyre fondeve. Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi supervizori i punimeve “D.....G” me përfaqësues ligjor z. W. M., z. K. K., znj. A. T. dhe z. G. K., të tre këta në rolin e Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO), z. A. A. dhe z. K. B., të dy këta në rolin e IPA Koordinator, përkatësisht pranë DPUK dhe AKUK (i njëjti institucion), z. M. S. dhe znj. E. K., të dy këta në rolin e Zyrtarit të Lartë të Programit (PAO) dhe znj. O. D., në cilësinë e specialistit pranë Sektorit të Menaxhimit të Kontratave
2.	Qeveria Shqiptare nuk ka siguruar që institucionet përfituese të projektit “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” të kenë resurse të përshtatshme financiare, materiale dhe njerëzore, në mënyrë që ndihma financiare e BE-së të përdoret në mënyrën më efektive dhe të qëndrueshme. Nga ana tjetër institucionet përfituese Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Koordinatori IPA (AKUM) dhe përfituesit final Bashkia Vlorë dhe Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Vlorë, nuk kanë ndërmarrë masat e kërkuara për adresimin e qëndrueshmërisë së projektit, përmes përgatitjes së një plan veprimi për vitin 2019, një mekanizmi për kompetencat e përbashkëta dhe një strukturë të përbashkët për koordinimin e operimit si edhe një kontrate performance ndërmjet AKUM dhe Bashkisë Vlorë, duke bërë që Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, në tetor 2018, të pezullojë pagesat për projektin e ndërtimit të sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza	41-43	E lartë	Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe, Koordinatori IPA (AKUM), përfituesit final Bashkia Vlorë dhe Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Vlorë, të marrin masa menjëherë dhe në vazhdimësi për hartimin e një plan veprimi për vitin 2019, ngritjen e një mekanizmi për kompetencat e përbashkëta dhe një strukturë të përbashkët për koordinimin e operimit si edhe një kontrate performance ndërmjet AKUM dhe Bashkisë Vlorë, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së projektit dhe zhblllokimin e pagesave për projektin e ndërtimit të sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza II, pjesë e IPA 2012 dhe eliminimin e efektit negativ prej 73,184.71 €.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SE, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	II, pjesë e IPA 2012			
3.	Institucioni përfitues i të projektit “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II”, Koordinatori IPA pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve, ka refuzuar fondin prej 3.4 milion € të ofruar nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri për të siguruar qëndrueshmërinë e ITUN Vlorë përmes mos pranimit të përfshirjes së stacionit të pompimit nr. 102 (ish fabrika e makaronave) në sistemin SCADA me qëllim monitorimin dhe sigurimin funksionimit e impiantit. Kjo ka shkaktuar mos zgjidhjen e problematikës të shkaktuar nga flukset e pakontrolluara hidraulike dhe mos garantimin e qëndrueshmërisë së projektit.	43-45	E lartë	Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) dhe Koordinatori IPA, të marrë masa në vazhdimësi, për zbatimin e Marrëveshjes Financiare me Komisionin Evropian në kuadër të IPA2012, (Menaxhimi i Decentralizuar) dhe kompetencave që i atribuon VKM nr. 23, datë 12.01.2011 duke përdorur të gjithë fondet e ofruara nga BE me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së projekteve përmes asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë dhe mbështetjes për kryerjen e reformave në përputhje me të drejtën Komunitare, me synimin përgatitjen plotësisht për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit për në Bashkimin Evropian.
4.	ITUN Vlorë që në fazat e tij fillestare është projektuar për të zhvilluar vetëm trajtimin paraprak dhe trajtimin primar të ujërave të ndotura që përfshijnë trajtimin fizik - mekanik dhe ndonëse qyteti i Vlorës paraqet një zonë sensitive mjedisore sa i përket bregdetit dhe zhvillimit të turizmit, në impiant nuk janë parashikuar të zhvillohen trajtimi sekondar qëllimi i të cilit është largimi i lëndëve organike të tretura si dhe trajtimi terciar që synon largimin e sasive të rëndësishme të azotit, fosforit, metaleve të rënda, lëndëve organike të biodegradueshme, baktereve dhe viruseve. Niveli i prurjeve në ITUN Vlorë është në nivelin 42% të mesatares së parashikuar të prurjeve, ndërsa deri në qershor 2019, 81.7% e objekteve që furnizohen me ujë janë të lidhur me rrjetin e	40-41	E lartë	Institucionet përfituese të projektit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUK, Bashkia Vlorë dhe UK sha Vlorë të marrin masa në vazhdimësi për të kërkuar dhe programuar konform praktikave ligjore parashikimin dhe implementimin e trajtimit sekondar e terciar në ITUN Vlorë. UK sha Vlorë të marrë masa për të rritur përqindjen e lidhjeve të popullsisë së qytetit të Vlorës me sistemin e kanalizimeve në mbi 90 %.





**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BESË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të zbatimit të Projektit. Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës* duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet si dhe nëse janë arritur apo jo objektivat e Projektit si më poshtë:

**Rezultati 1**

7. Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura është rehabilituar sipas gjendjes së tij origjinale të projektuar;
8. Njësia e menaxhimit të materialeve është ndërtuar;
9. Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura është duke operuar në gjendje të qëndrueshme;
10. Stafi i Ujësjetllës Kanalizime Vlorë është trajnuar se si të operojë rrjetin e sistemit të kanalizimit;
11. Sipërfaqja brenda kufijve administrativë të Bashkisë Vlorë të jetë mbuluar me rrjetin përkatës të kanalizimit, duke përfshirë zonën që strehon pusët e ujit të pijshëm që furnizojnë popullatën;
12. Uji i ndotur i mbledhur nga rrjeti i kanalizimit brenda kufijve administrativë të Bashkisë Vlorë trajtohet në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura

**Rezultati 2**

2. Punimet e kontratave brenda projektit janë implementuar në cilësi të mirë, në kohë dhe plotësisht në linjë dhe rregullat përkatëse teknike dhe specifikimet;

**Rezultati 3**

2. Qëndrueshmëria e operacioneve dhe mirëmbajtja janë të mbështetura;

Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë* ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të marrëveshjes si dhe kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. *Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).*

**d. Identifikimi i çështjes:**

CFCU, si strukturë operative, duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së menaxhimit administrativ efektiv, financiar dhe teknik të projekteve të miratuara sipas Marrëveshjeve Financiare me Komisionin Evropian, Bankën Botërore dhe Donatorë të Tjerë, duke patur gjithnjë në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

**e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim**

CFCU ka si përgjegjësi kryesore të saj tenderimin, kontraktimi, zbatimin e kontratave, kryerjen e pagesave, kontabilitetin, kërkesë për fonde dhe menaxhim të llogarive bankare, monitorimin & kontrollin si dhe raportimin.

**f. Përgjegjësitë e audituesve**

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit mbi çështjet nën auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BESË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

**g. Kriteret e vlerësimit**

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “*Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”; Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH, Marrëveshjet e Financimit të lidhura mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian në lidhje me Programin Kombëtar për vitin 2012 në kuadrin e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) (*komponenti i Asistencës së Tranzicionit dhe Forcimit Institucional*) si dhe amendimeve përkatëse; Marrëveshja Operacionale e lidhur mes Koordinatorit Kombëtar për IPA (NIPAC) e përfaqësuar nga Ministri i Integritimit, Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO) e përfaqësuar nga CFCU si dhe Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO) i përfaqësuar nga Ministria e Transportit, e ndryshuar, për vendosjen e një marrëdhënieje pune formale që palët e mësipërme kanë për implementimin e komponentit 1 “*Asistenca për Tranzicionit dhe Forcimin e Institucioneve*”, Marrëveshjen Operacionale specifike për Projektin “*Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë , faza II*” të lidhur në qershor 2016 mes Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO) e përfaqësuar nga CFCU, Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO) i përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës si dhe ‘*Përfituesit*’ e përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës – Kanalizime (DPUK, sot AKUM), për përgjegjësinë e përbashkët mes palëve të mësipërme për menaxhimin indirekt të kontratës së punimeve; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për arkivat*”; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar; Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996 “*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përdorimit të ujërave të ndotura*” i ndryshuar; Ligji nr. 8306, datë 14.03.1998 “*Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë*”; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”; Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 “*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*”, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar; VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 “*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*”; VKM nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar; VKM nr. 23 datë 12.01.2011 “*Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), Komponenti I : Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi institucional*”; VKM nr. 116, datë 24.02.1997 “*Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë*”; VKM nr. 452, datë 01.07.1998 “*Për disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huaj*”; VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “*Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK*”, VKM nr. 236, datë 10.05.1993 “*Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjarë dhe jo familjar*” i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik*”; Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të*



**KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

*Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*”; Udhëzimi KM nr. 2, datë 08.05.2003 *“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”*; Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*

**h. Standardet e auditimit**

- ISSAI 100 – *(Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)*
- ISSAI 400 – *(Parimet themelore të auditimit të përpunueshmërisë).*

**III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

Drejtorja e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktive për Fondet e BE, BB dhe Donatorëve të tjerë (CFCU) është strukturë operative kryesore për menaxhimin indirekt të fondeve IPA si dhe zbatimin e projekteve të Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë. Misioni i saj është të sigurojë një menaxhim administrativ efektiv, financiar dhe teknik të projekteve të miratuara sipas Marrëveshjeve Financiare me Komisionin Evropian, Bankën Botërore dhe Donatorë të tjerë. Kjo drejtori është ngritur fillimisht si pjesë e strukturës së Ministrisë së Financave me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 596 datë 05.09.2007 *“Për Ngritjen e Strukturave dhe Përcaktimin e Autoriteteve e të Përgjegjësive për Zbatimin e Instrumentit të Parazgjerimit”*. Roli i CFCU-së si dhe roli i institucioneve dhe autoriteteve kryesore që janë pjesë e strukturës së Sistemit të Menaxhimit të Decentralizuar të IPA’s, është amenduar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 12.01.2011, me VKM nr. 850 datë 14.12.2011, me VKM nr. 707 datë 21.08.2013 dhe VKM nr. 300 datë 23.05.2018.

Përgjegjësitë kryesore të kësaj drejtorie janë:

- Tenderimi;
- Kontraktimi;
- Zbatimi i kontratave;
- Kryerja e pagesave, kontabiliteti, kërkesë për fonde dhe menaxhim të llogarive bankare;
- Monitorimin & kontrollin;
- Raportimi

Për realizimin e detyrave si më sipër, kjo Drejtori e Përgjithshme është e strukturuar në dy Drejtori dhe sektorë si më poshtë:

**A. Drejtorja e Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktive për fondet e BE:**

1. Sektori i menaxhimit të prokurimeve;
2. Sektori i menaxhimit të kontratave;
3. Sektori i menaxhimit financiar;
4. Sektori i kontrollit;
5. Sektori i sigurimit të cilësisë;

**B. Drejtorja për zbatimin e projekteve të Bankës Botërore dhe donatorëve të tjerë:**

1. Sektori i menaxhimit të prokurimeve;
2. Sektori i menaxhimit financiar;

Objekti *“Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë , Faza II”* për të cilin është realizuar Projekti i Auditimit është pjesë integrale e financimeve sipas IPA 2012, Komponenti 3 *Zhvillimi Rajonal*, sektori *Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike* dhe ka parashikuar si strukturë operative Ministrinë e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit. Mbështetja nga IPA është parashikuar vlera prej 18.5 mln € nga 21.2 mln € (87 %) vlera totale e shpenzimeve të parashikuara për këtë objekt i cili ka si objektiv përmirësimin e mjedisit, jetesës dhe shëndetit dhe kushteve të popullsisë së Vlorës përmes përafrimit me standardet e BE të cilësisë së ujit dhe trajtimit të



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

ujërave të zeza. Ky objektivi është parashikuar të realizohet përmes dy kontratave, një kontratë për punime dhe një kontratë për shërbime supervizimi.

### **Objektivi**

Objektivi kryesor i auditimit është **dhënia e opinionit bazuar në vlerësimin** dhe evidentimin e shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si edhe shfrytëzimin me eficiencë, efektivitet dhe economicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike dhe/apo granteve, ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve. Auditimi u fokusua në mangësitë e konstatuara në aspekte që kanë të bëjnë me menaxhimin e procesit të realizimit të kontratave përkatëse.

*Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).*

**Qëllimi i auditimit** është hartimi i Raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve për periudhën nga fillimi i Projektit deri me datë 31.05.2019 si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të Drejtorisë.

Është audituar prokurimi dhe/ose zbatimi i dy kontratave, asaj të shërbimit të konsulencës dhe kontratës së punimeve për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm.

## **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

### **1. Kuadri ligjor i miratuar në lidhje me përfitimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadrin e implementimit të fondeve IPA 2012 si dhe ndryshimet e tij gjatë implementimit. Përfitimet e institucionit referuar kontratave të miratuara për përfituesin (listimeve të miratuara)**

Në bazë të Vendimit për Implementim të Komisionit Evropian me nr. C(2012) 8208, datë 09.11.2012 “Për adoptimin e një programi kombëtar për Shqipërinë nën IPA – Komponenti Asistenca për tranzicionin dhe Ndërtimi i Institucioneve për vitin 2012”, është parashikuar dhënia e një kontributi nga BE në total në shumën 81,640,000 €. Pas Vendimit të KE dhe Marrëveshjes së Financimit të lidhur mes Këshillit të Ministrave të Qeverisë Shqiptare dhe KE më 13 Dhjetor 2012, palët e mësipërme miratuan Programin Kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e komponentit IPA ‘Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional’ për vitin 2012 i parashikuar për tu zbatuar nga Komisioni në mënyrë të centralizuar. Programi me nr. 2012/23-036 (CRIS) është titulluar “Programi Kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e Komponentit IPA ‘Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional’”.

Kjo marrëveshje financimi është amenduar 2 herë:

**1.** Sipas amendimit nr. 1, KE pas miratimit më 25 mars 2014 të Vendimit nr. C(2014) 1890 i ka dhënë Shqipërisë kompetencat e menaxhimit, ose thënë ndryshe mundësimin e zbatimit në mënyrë të decentralizuar vetëm të dy projekteve, konkretisht ‘Ndërtimi i godinës së Gjykatës së Tiranës – faza I’ dhe ‘Instrumenti për Përgatitjen e Projekteve për Njësinë Qendrore të



**KONTROLI I LARTË I SHETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

*Financimit dhe Kontraktimit (CFCU) në Ministrinë e Financave*. Po sipas të njëjtit amendim, pas miratimit të Vendimit të KE me nr. C(2014) 2846 të datës 24 prill 2014, janë rritur përkatësisht me shumat (+800,000 €) dhe (+99,000 €) projektet me menaxhim të decentralizuar ‘Mbështetje për Policinë e Shtetit’ dhe ‘Pjesëmarrja në Programet e BE-së’ duke ulur nga ana tjetër vlerën e buxhetit për projektin “Instrumenti për Përgatitjen e Projekteve dhe Forcimin e Procesit të Integritimit Evropian”. Ndryshimet e mësipërme jepen sipas Shtojcave nr. A1 dhe nr. A2 sipas të cilave shuma prej 81,640,000 € është ndarë në dy vlera:

- a. 69,440,000 € të alokuara për Programin IPA 2012, projektet e implementuara në mënyrë të centralizuar, duke përfshirë edhe menaxhimin e centralizuar indirekt;
- b. 12,200,000 € të alokuara për Programin IPA 2012, projektet e implementuara në mënyrë të decentralizuar;

Me marrëveshjen e parë, **financimi i projektit objekt auditimi ka qenë i parashikuar të përfshihet brenda fondit prej 69,440,000 €, pra në projektet me menaxhim të centralizuar indirekt.**

2. Pas Vendimit të KE me nr. C(2015) 5260 të datës 22.07.2015 i cili ka amenduar Vendimin e mëparshëm është lidhur Marrëveshja e Financimit në zbatim të këtij vendimi. Sipas Amendimit nr. 2 të Marrëveshjes së Financimit të mbajtur me datë 23.07.2015 mes KE si përfaqësues i BE dhe qeverisë Shqiptare e përfaqësuar nga Ministri i Integritimit Evropian znj. K. Gj. është rënë dakord mes palëve se:

*“Përfituesi ka kapacitete administrative të zhvilluara mjaftueshëm për të lejuar zbatimin e decentralizuar të programeve vjetore nën kuadrin e komponentit IPA - Asistenca e Tranzicionit dhe Mbështetja Institucionale”.*

Sipas kësaj marrëveshjeje dhe konkretisht anekseve bashkëlidhur janë përcaktuar si më poshtë:

- Kontributi i EU – 24,700,000 €;
- Autoriteti Implementues – CFCU, njësia brenda Ministrisë së Financave e cila do të jetë edhe Autoritet Kontraktor për të gjitha projektet dhe do të jetë përgjegjëse për të gjitha aspektet procedurale të tenderimit, çështjet e kontraktimit dhe menaxhimit financiar, duke përfshirë këtu edhe pagesat për aktivitetet e projektit. Drejtuesi i CFCU do të operojë edhe si Zyrtari Autorizues i Programit (PAO);
- Data finale për mbylljen e marrëveshjeje financiare – firmosur më 13.12.2012;
- Data finale për përmbylljen e kontratave të prokurimit dhe grantit – 13.12.2015 me përjashtim të rasteve të listuara në artikullin 189.2 FR 966/2012;
- Data finale për implementimin operacional – 13.12.2018, me përjashtim të projektit nr. 2, “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë , Faza II” për të cilin data finale e operacionit është parashikuar data 13.12.2019;
- Data finale për të implementuar Marrëveshjen Financiare – 13.12.2023;
- Linja buxhetore – 22.02.02: Programe Kombëtare (Komponenti Asistenca për Tranzicionin dhe Ndërtimi Institucioneve) për vendet Potenciale Kandidate;
- Njësia e Programimit – Njësia C4, Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit;
- Delegacioni Evropian – Delegacioni Evropian në Shqipëri;

Sipas kësaj marrëveshjeje vlera prej 81,640,000 € është parashikuar të implementohet si më poshtë:

- a. 56,940,000 € të alokuara për Programin IPA 2012, projektet e implementuara në mënyrë të centralizuar, duke përfshirë edhe menaxhimin e centralizuar indirekt;



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

b. 24,700,000 € të alokuara për Programin IPA 2012, projektet e implementuara në mënyrë të **decentralizuar**;

c. Sipas pikës 2.2, paragrafit i katërt citohet se:

Nën metodën e decentralizuar të menaxhimit, njësia e CFCU – së është parashikuar të jetë përgjegjëse për të gjitha aspektet administrative dhe procedurale të procesit të tenderimit. Me qëllim lehtësimin e kësaj detyre, Programi IPA 2012 përfshin një ndihmë financiare sipas të cilës CFCU mund të mbështetet për të mobilizuar ekspertizë Ad Hoc për përgatitjen e procedurave të tenderit në lidhje me shërbime, punime ose furnizime. Kjo njësi do të aktivizohet për të përgatitur në mënyrën e duhur setin e projekteve të decentralizuara nën Programin Kombëtar IPA 2013. Mbështetja nga IPA ngelet po e njëjta si në marrëveshjen e mëparshme dhe konkretisht vlera prej 18.5 mln € nga 21.2 mln € (87 %). Sipas amendamentit nr. 2 (në total janë bërë përcaktimet si më poshtë:

- Kostoja totale e Projektit (PA TVSh) – 21,200,000 €;
- Kontributi i Bashkimit Evropian – 18,500,000 €;
- Mënyra e menaxhimit – E decentralizuar;
- Agjencia e Implementimit – Njësia e CFCU, znj. A. B. ish – Drejtore e Përgjithshme e CFCU, në rolin e PAO (Nëpunës Autorizues i Programit);
- Menaxhimi i Implementimit:
  - d. znj. A. T., Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Integritimit dhe Koordinimit e projekteve IPA, në rolin e SPO (Nëpunës i Lartë Autorizues);
  - e. z. A. A., Drejtor i Përgjithshëm i DPUK;
  - f. z. A. A., Koordinator i projekteve IPA në DPUK;

Ky projekt synon në vetvete të ulë ndotjen e ujit, të përmirësojë kushtet e jetesës dhe të shëndetit për popullsinë e Bashkisë Vlorë si dhe të përmirësojë kushtet për zhvillimin e rajonit përmes zgjerimit të rrjetit të kanalizimit dhe rehabilitimit të impiantit ekzistues të ujërave të ndotura. Në fund të projektit pjesa më e madhe e Bashkisë Vlorë duhet të jetë lidhur me rrjetin e kanalizimit dhe pjesa më e madhe e ujërave të ndotur do të trajtohet në impiant përpara shkarkimit të tij tek vepra marrëse. Implementimi i këtij projekti vjen si një zbatim i çështjeve të miratuara si prioritete nga Strategjia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizime për Shqipërinë, miratuar me VKM nr. 342 datë 12.03.2008 në të cilën janë theksuar këto dy pika:

1.b “*Rritja e lidhjeve të popullsisë urbane dhe rurale me rrjetin mbledhës të kanalizimeve*”;

1.d “*Rrija e % së popullsisë së lidhur me rrjetin mbledhës të kanalizimeve direkt me impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura*”.

Konkretisht ky projekt pjesë e IPA 2012 parashikon:

- të vazhdojë ndërtimin e rrjetit të kanalizimit për të mbuluar të gjithë qytetin e Vlorës (vazhdimin e punimeve të nisura me IPA 2009);
- të rehabilitojë impiantin ekzistues të trajtimit të ujërave të ndotura në gjendjen e tij fillestare të projektuar dhe ta zgjasë atë deri në pikën e objektit e menaxhimit të materialit;
- të mundësojë operimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura dhe rrjetit nga kontraktori i punimeve për 2 vite pas përfundimit të tij duke përfshirë trajnimin e stafit të Ujësjiellës Kanalizime Vlorë;
- të furnizojë pajisjet laboratorike si dhe makineritë dhe mjetet e nevojshme për operimin dhe mirëmbajtjen e impiantit dhe të gjithë infrastrukturës së rrjetit të kanalizimeve;
- të mundësojë shërbime supervizimi gjatë ndërtimit, periudhës së defekteve dhe gjatë periudhës funksionale dy vjeçare;



**KONTROLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

- të mundësojë asistencë teknike për të mbështetur implementimin e planit të veprimit të kapitullit 2.6;

Rezultatet e pritura nga ky projekt janë si më poshtë:

Aktiviteti 1 – Punimet

Rezultati 1

13. Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura është rehabilituar sipas gjendjes së tij origjinale të projektuar;
14. Njësia e menaxhimit të materialeve të mbetura është ndërtuar;
15. Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura është duke operuar në gjendje të qëndrueshme;
16. Stafi i Ujësjellës Kanalizime Vlorë është trajnuar se si të me rrjetin e sistemit të kanalizimit;
17. Sipërfaqja brenda kufijve administrativë të Bashkisë Vlorë të jetë mbuluar me rrjetin përkatës të kanalizimit, duke përfshirë zonën që strehon puset e ujit të pijshëm që furnizojnë popullatën;
18. Uji i ndotur i mbledhur nga rrjeti i kanalizimit brenda kufijve administrativë të Bashkisë Vlorë trajtohet në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura

Aktiviteti 2 – Supervizimi

Rezultati 2

3. Punimet e kontratave brenda projektit janë implementuar në cilësi të mirë, në kohë dhe plotësisht në linjë dhe rregullat përkatëse teknike dhe specififikimet;

Aktiviteti 4 – Asistenca Teknike

Rezultati 3

3. Qëndrueshmëria e operacioneve dhe mirëmbajtja janë të mbështetura;

Tabela e treguesit të buxhetit nën IPA 2012 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 1

Titulli i Projektit		TOTAL	TOTAL SHPENZIME PUBLIKE	Kontributi IPA		Burimi i Fondeve		
						Kontributi Kombëtar		
Ujësjellësi i Vlorës		Shpenzime	EUR	EUR	%	Total	%	Central
IB	INV	EUR	(b)=(c)+(d)	(b)	-2	EUR	-2	EUR
-1	-1	(a)=(b)+(c)+(d)				(c)=(x)+(y)+(z)		(x)
	X	<b>18,500,000</b>	<b>18,500,000</b>	<b>16,600,000</b>	<b>89,73%</b>	<b>1,900,000</b>	<b>10,27%</b>	<b>1,900,000</b>
Kontrata 1.1	X	16,600,000	16,600,000	16,600,000	100,00%	0	0,00%	
Kontrata 1.2	X	1,900,000	1,900,000	0	0,00%	1,900,000	100,00%	1,900,000
Aktiviteti 2	X	<b>1,800,000</b>	<b>1,800,000</b>	<b>1,800,000</b>	<b>88,89%</b>	<b>200,000</b>	<b>11,11%</b>	<b>200,000</b>
Kontrata 2.1	X	1,600,000	1,600,000	1,600,000	100,00%	0	0,00%	
Kontrata 2.2	X	200,000	200,000	0	0,00%	200,000	100,00%	200,000
Aktiviteti 3	X	<b>600,000</b>	<b>600,000</b>	<b>0</b>	<b>0,00%</b>	<b>600,000</b>	<b>100,00%</b>	<b>600,000</b>
Kontrata 3.1	X	600,000	600,000	0	0,00%	600,000	100,00%	600,000
Aktiviteti 4	X	<b>300,000</b>	<b>300,000</b>	<b>300,000</b>	<b>100,00%</b>	<b>0</b>	<b>0,00%</b>	
Kontrata 4.1	X	300,000	300,000	300,000	100,00%	0	0,00%	
TOTAL IB		300,000	300,000	300,000	100,00%	0	0,00%	0
TOTAL INV		20,900,000	20,900,000	18,200,000	<b>87,08%</b>	2,700,000	<b>12,92%</b>	2,700,000
Projekti TOTAL		<b>21,200,000</b>	<b>21,200,000</b>	<b>18,500,000</b>	<b>87,26%</b>	<b>2,700,000</b>	<b>12,74%</b>	<b>2,700,000</b>

## 2. Prokurimi i fondeve si dhe ndjekja e procedurave të vlerësimit dhe kontraktimit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe konkretisht:



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

- 1- Dokumenti me subjekt *Dorëzimi (Hand Over)* dërguar nga Delegacioni në Shqipëri i BE, drejtuar z. M. S., ish – Drejtor i CFCU, administruar në CFCU me nr. 15726 prot., datë 12.11.2015;
- 2- Vendimit për Implementim të KE me nr. C(2012) 8208, datë 09.11.2012 “Për adoptimin e një programi kombëtar për Shqipërinë nën IPA – Komponenti Asistenca për tranzicionin dhe Ndërtimi i Institucioneve për vitin 2012”;
- 3- Vendimi i KE i datë 25.03.2014 nr. C(2014) 1890;
- 4- Vendimi i KE i datë 22.07.2014 nr. C(2015) 5260;
- 5- <https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?do=publi.welcome&PubliList=15&orderby=upd&orderbyad=Desc&searchtype=RS&aofr=136785>

rezultoi se procedura e prokurimit të projektit “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë , Faza II” ka nisur nën mënyrën e centralizuar të menaxhimit të fondeve dhe konkretisht me të dhënat si më poshtë:

Referenca e publikimit - EuropeAid/136785/DH/ËKS/AL;

Lloji i procedurës – E hapur;

Emërtimi i programit – Programi Kombëtar për Shqipërinë nën IPA Komponenti *Asistenca për Tranzicionin dhe Ndërtimi i Institucioneve*, për 2012, numri i programit 2012/023-036;

Linja buxhetore – 22.02.02 (programe kombëtare për vende Kandidate Potenciale);

Autoriteti Kontraktor – Unioni Evropian, i përfaqësuar nga KE, i cili është përfaqësuar në vetvete nga Delegacioni i BE në Shqipëri;

Publikimi i kontratës – Prill 2015;

Në vijim, rezulton se ka patur disa korrigjime të ndodhura në 4 raste dhe sqarime në 2 raste lidhur me përmbajtjen e dokumenteve dhe/apo sqarimeve të nevojshme. Gjatë kësaj periudhe, është realizuar, pas Vendimit të KE me nr. C(2015) 5260 të datës 22.07.2015 i cili ka amenduar Vendimin e mëparshëm me nr. C(2012) 8208, datë 09.11.2012 “Për adoptimin e një programi kombëtar për Shqipërinë nën IPA – Komponenti Asistenca për Tranzicionin dhe Ndërtimi i Institucioneve për vitin 2012” lidhja e Marrëveshjes së Financimit në zbatim të këtij Vendimi. Sipas këtij amendimi nr. 2 të Marrëveshjes së Financimit është rënë dakord mes palëve se:

*“Përfituesi ka kapacitete administrative të zhvilluara mjaftueshëm për të lejuar zbatimin e decentralizuar të programeve vjetore nën kuadrin e komponentit IPA - Asistenca e Tranzicionit dhe Mbështetja Institucionale”.*

Sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe konkretisht anekseve bashkëlidhur janë përcaktuar si më poshtë:

- Kontributi i EU – 24,700,000 €;
- Autoriteti Implementues – CFCU, njësia brenda Ministrisë së Financave e cila do të jetë edhe Autoritet Kontraktor për të gjitha projektet dhe do të jetë përgjegjëse për të gjitha aspektet procedurale të tenderimit, çështjet e kontraktimit dhe menaxhimit financiar, duke përfshirë këtu edhe pagesat për aktivitetet e projektit. Drejtuesi i CFCU do të operojë edhe si Zyrtari Autorizues i Programit (PAO);
- Data finale për mbylljen e marrëveshjes financiare – firmosur më 13.12.2012;
- Data finale për mbylljen e kontratave të prokurimit dhe grantit – 13.12.2015 me përjashtim të rasteve të listuara në artikullin 189.2 FR 966/2012;



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

- Data finale për implementimit operacional – 13.12.2018, me përjashtim të projektit nr. 2, “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë , Faza II” për të cilin data finale e operacionit është parashikuar data 13.12.2019;
- Data finale për të implementuar Marrëveshjen Financiare – 13.12.2023;
- Linja buxhetore – 22.02.02: Programe Kombëtare (Komponenti Asistenca për Tranzicionin dhe Ndërtimi i Institucioneve) për vendet Potenciale Kandidate;
- Njësia e Programimit – Njësia C4, Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit;
- Delegacioni Evropian – Delegacioni Evropian në Shqipëri;

Sipër kësaj marrëveshjeje vlera prej 81,640,000 € është parashikuar të implementohet si më poshtë:

- d. 56,940,000 € të alokuara për Programin IPA 2012, projektet e implementuara në mënyrë të centralizuar, duke përfshirë edhe menaxhimin e centralizuar indirekt;
- e. 24,700,000 € të alokuara për Programin IPA 2012, projektet e implementuara në mënyrë të decentralizuar;
- f. Sipas pikës 2.2, paragrafit i katërt citohet se:

Për efekt të këtij ndryshimi, pra kalimit nga forma e centralizuar në atë decentralizuar të menaxhimit të projektit në fjalë, si dhe referuar dokumentit me i cili mban datën 11.11.2015, me nr. 15726 prot., datë 12.11.2015 të Ministrisë së Financave, dërguar nga ana Delegacionit të BE në Shqipëri, procedura e vlerësimit është kryer nga e këtij Delegacioni dhe më tej është miratuar me procedurë të veçantë nga CFCU. Me datë 09.12.2015 është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë “APULIA” S.r.l, Itali dhe “E... & ...I” S.r.l Itali me të cilët është lidhur kontrata me nr. AL/IPA2012/05 me vlerë të kontratës 13,185,268.61 € pa TVSh ose 15,822,322.33 € me TVSh.

### **3. Mbi zbatimin e kontratave lidhur me projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë , Faza II” të komponentit III “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”.**

#### **a. Titulli i Gjetjes: Negocime çmimesh për zëra të rinj jashtë preventivit në kundërshtim me kushtet e kontratës.**

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit teknik të dosjes së zbatimit për kontratën e punimeve me objekt “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë , Faza II” të lidhur sipas aktit me nr. AL/IPA2012/04 datë 09.12.2015 mes z. M. S. ish – Drejtor i Përgjithshëm në CFCU, në rolin e punëdhënësit, z. S. F. Administrator i “A...A” S.r.l, Itali, në rolin e përfaqësuesit të BOE, u konstatua se janë negociuar si më poshtë:

- a) Punime të montimit me çmime dhe me strukturë kostoje njësojë si punime ndërtimi;
- b) Zëra të rinj me normativa mbi ato të manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi në kohën e realizimit të punimeve;
- c) Zëra të rinj me një fitim prej 10 %, kur në fakt në kontratë është parashikuar një fitim prej 5 % mbi kostot;

Si rrjedhojë e këtyre analizave të gabuara rezulton se janë përdorur pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet shuma **156,557 €** si rrjedhojë e pasaktësive përkatëse. Konkretisht rezultoi sipas tabelës:

Tabela nr. 2

Identifikimi në Kontratë	Loti	Vlera pa EEE (€)
--------------------------	------	------------------



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

VO 1	2	190
VO 2	2	-
VO 3	1	42,337
VO 4	2	80,045
VO 5	1	-
VO 6	1	30,080
VO 7	1	-
VO 8	2	-
VO 9	1	3,905
Σ Loti 1		76,322
Σ Loti 2		111,394
<b>TOTAL</b>		<b>156,557</b>

E argumentuar kjo si më poshtë:

Urdhri i ndryshimit nr. 1

Analiza e zërave të rinj për pastrimin e linjave me diametër Φ 200 mm dhe 250 mm si dhe pusetave ekzistuese është bërë duke përfshirë një përfitim prej 10 % të shumës së shpenzimeve të drejtpërdrejta dhe atyre plotësuese. Duke bërë korrigjimet rezultojnë se janë përdorur pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet shuma prej **190 €** e cila argumentohet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 3

Nr.	Emërtimi i zërit	Çmimi i Ofertës	Çmimi i korrigjuar	Diferenca në Çmim	Volumi	Diferenca në vlerë
1	Pastrim tubi Φ 200	6.8	6.42	0.38	289.6	109
2	Pastrim tubi Φ 250	6.8	6.42	0.38	70	26
3	Pastrim pusete	64.86	58.86	6.0	9	54
<b>SHUMA</b>						<b>190</b>

Urdhri i ndryshimit nr. 3

Referuar dokumentit Shënimet Shpjeguese (*Explanatory Note*) është cituar midis të tjerave se kostoja e hartuar nga kontraktori është kontrolluar në bazë të VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Konkretisht janë parashikuar kostot si më poshtë:

- Punime Civile;
  - a) Ndërtimi i një depozite llumi 155,200 €;
- Punime mekanike;
  - a) Instalimi i 14 motorëve elektrikë 63,250 €;
  - b) Makineria e pastrimit të llumit 150,066 €;
  - c) Tanku i llumit 34,750 €;
- Punime elektrike dhe të skadës;
  - a) Sheshimi dhe heqja e barit 22,960 €;
  - a.a Punime për skadën 23,693.45 €;
  - b) Pellgjet anaerobe 4,927 €;
  - c) Tanku i llumit 28,324.19 €;

Në total këto punime parashikojnë një vlerë prej 483,171.53 €. Nga këto, është zbritur vlera për efekt të kalimit nga 11 shtretër në 9 duke zvogëluar kështu vlerën prej 145,379.74 €, duke nxjerrë si domosdoshmëri përdorimin e fondit rezervë të Lotit 1 në shumën 337,791.79 €. Në përlllogaritjen e impaktit në kosto rezultojnë se nuk janë përlllogaritur saktë shumat e zbritshme nga



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SE, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

kalimi nga 11 shtretër llumi në 9 të tilla. Referuar preventiv ofertës rezulton se në total, punimet për realizimin e 11 shtretërve për tharjen e llumit janë ofertuar nga ana e kontraktorit në shumë prej 1,277,298.01 € + një shumë rezervë prej 15,482.40 €. Zbritja me 2/11 nuk është bërë për të gjitha zërat që lidhen me shtretërit e llumit por është bërë vetëm për 6 zëra nga 8 zëra në total dhe nuk është bërë për zërat e tjerë që lidhen me shumën rezervë. Konkretisht nuk janë zbritur zërat me nr. 2.14 dhe nr. 2.15 të cilat lidhen me Sistemin e shkarkimit të llumit dhe dërgimin e tyre në shtretërit e tharjes. Nisur nga fakti që këta shtretër janë reduktuar nga 11 në 9, rezulton se kjo diferencë nuk është marrë në konsideratë gjatë zvogëlimit të kostove. Kështu diferenca e zbritshme duhet të ishte në shumën 163,494 € (899,217.8 x 2/11) për shtretërit + 2,815 € (15,482.40 x 2/11) për shumën rezervë, ose 166,309 € në total. Si rrjedhojë, janë zbritur 20,929 € më pak (166,309 € - 145,379 €), vlerë kjo e cila përfaqëson një përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve. Gjithashtu, u konstatua se analiza e kostos së blerjes, transportimit dhe vendosjes mbi vaska e makinerisë së pastrimit të llumit me vlerë 150,066 € është bërë njësojë si për punimet e ndërtimit në bazë të manualit teknik të çmimeve duke përllogaritur një kosto si më poshtë:

Tabela nr. 4

Furnizim dhe instalim i dragës lundruese	copë	Punëtori			Transport			Makineri			Materiale		
		3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	2			3 x 4			6 x 7			9 x 10			12 x 13
Sp + p	op	170	1.85	314.5									
Sigurime shoqërore 16.7%	€	314.5	0.17	52.52									
Transport nga Gjermania	€				1,915	3	5,745						
Vinç	op							3	40	120			
Dragë lundruese	copë										1	110,321.85	110,321.85
<b>Shuma :</b>				<b>367.02</b>			<b>5,745</b>			<b>120</b>			<b>110,321.85</b>

15 5+8+11+14	16 8 % x 15	17 10 % x 16	18 15+16+17
<b>116,553.87</b>	9,324.31	12,587.82	<b>138,466.00</b>

Vlerës së mësipërme prej 138,466 € i janë shtuar edhe vlera e punimeve prej 11,600 € për furnizimin dhe vendosjen e tubave HDPE DN 110 PN10 duke argumentuar kështu vlerën prej 150,066 € që është paraqitur nga ana e kontraktorit për këtë urdhër ndryshimi. Në fakt, përllogaritja e mësipërme është e gabuar pasi:

- Furnizimi dhe vendosja nëpër vaska e makinerive lundruese të llumit nuk është punim ndërtimi dhe si i tillë nuk mund ti nënshtrohet kësaj mënyrë të përllogaritjes së kostos;
- Vlera e blerjes së mjetit lundrues nuk mund të përfshihet as tek shpenzimet e drejtpërdrejta dhe as tek shpenzimet e përgjithshme dhe si e tillë, vlerës së furnizimit së mjetit nuk mund ti shtohet vlera prej 8 % si shpenzim i përgjithshëm dhe as ajo prej 10 % si fitim për sipërmarrësin pasi nuk është as punim ndërtimi dhe as punim teknologjik;
- Referuar udhëzimit të përmendur më sipër, në Kreun I, germa A, paragrafi Shpenzimet Për Makineri citon se:

*“Shpenzimet për makineri janë shpenzimet për makineritë që përdoren për punimet e ndërtim-montimit kohën e punës, vlerësuar me çmimet orare përkatëse, pa TVSH”.* Pra me ‘makineri’



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BESË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

përfshihen ato të cilat përdoren për punët e ndërtim – montimit dhe jo ato që trupëzohen në vepër.

Për sa i përket punimeve të mirëfillta të ndërtimit që lidhen me makineritë e pastrimit të llumit dhe shkarkimit të tyre, rezulton se këto punime janë parashikuar në zërin nr. 2 ‘Furnizim dhe vendosje e tubit HDPE DN 110 PN 10 thellësi jo më shumë se 1.5 m, përfshirë zgjatjet e HDPE ..’ me çmim të pranuar prej 11,600 €. Rrjedhimisht, furnizimi i makinerive lundruese për pastrimin e llumit nuk mund të konsiderohet punim ndërtimi pasi as nuk është i tillë dhe as nuk përfshin në analizën e kostos punime të tilla. Duke bërë korrigjimet e nevojshme, vlera me të cilën duhet të ishte pranuar ky zë është si më poshtë:

Tabela nr. 5

Furnizim dhe instalim i dragës lundruese	copë	Punëtori			Transport			Makineri			Materiale			
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
					3 x 4			6 x 7			9 x 10			12 x 13
Sp + p	op	170.00	1.85	314.5										
Sigurime shoqërore 16.7%	€	314.5	0.17	52.52										
Transport nga Gjermania	€				1,915	3.00	5,745							
Vinç	op							3	40	120				
<b>Shuma :</b>				<b>367.02</b>			<b>5,745</b>			<b>120</b>				<b>110,321.85</b>

15 5+8+11	16 50 % x 5	17 5 % x (15+ 16)	18 15+16+17	19 çmimi i dragës	20 18+ 19	21 Çmimi i punimeve për tubat HDPE	22 20+21 çmimi total
<b>6,232.02</b>	<b>183.51</b>	<b>320.78</b>	<b>6,736.30</b>	<b>110,321.85</b>	<b>117,058.15</b>	<b>11,600</b>	<b>128,658.155</b>

Pra çmimi i korrigjuar është 128,658.15 €. Diferenca prej 21,407.83 € përfaqëson një përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve.

Urdhri i ndryshimit nr. 4

Nga auditimi rezulton se përlllogaritja e analizave e kostos e hartuar nga kontraktori dhe e miratuar nga të gjitha palët, për çmimet e reja jashtë preventivit fillestar të ofertës, nuk janë hartuar në përputhje me kushtet e veçanta të kontratës, neni 1.4 ku përcaktohet se “Ligji i aplikueshëm për zbatimin e projektit i cili është subjekti i kësaj kontrate do të jetë ligji i Republikës së Shqipërisë”. Sa më sipër rezulton pasi analizat e kostove të hartuara të hartuara nga ana e kontraktorit e të miratuara nga supervizori, Autoriteti Kontraktor, DPUK dhe SPO rezultojnë se janë mbi normativat e miratuara nga manuali teknik i çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi në momentin e zbatimit të punimeve dhe konkretisht atij sipas VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Volumet dhe çmimet e pranuar mbi normativat e VKM – së paraqiten të argumentuara teknikisht dhe analitikisht si më poshtë:

- Për montimin e tubave HDPE PN6 me diametër 250 mm, 315 mm, 400 mm, 500 mm dhe 630 mm për thellësi vendosjeje të tubacionit 2.5 m – 3.0 m, 3.0 m – 3.5 m, 3.5 m – 4.0 m dhe mbi 4.0 m rezultuan diferenca në vlerë si pasojë e rritjes së çmimit të punëtorisë dhe marzhit të fitimit. Si rrjedhojë, duke bërë korrigjimet përkatëse rezulton se janë përdorur pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet fondet në shumën 61,976 €, e argumentuar kjo sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 6



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

Nr.	Tub HDPE 250 mm PN6	Çmimi i Ofertës (€)	Çmimi i korrigjuar (€)	Diferenca në Çmim (€)	Volumi i preventivit	Diferenca në vlerë (€)
1	h=2.5-3.0 m	72.8	66,30	6,5	2127,9	13.834
2	h=3.0-3.5 m	76.9	70,28	6,6	1256	8.311
3	h=3.5-4.0 m	79.5	72,48	7,0	435	3.055
3	h=> 4.0 m	95.2	87,22	8,0	383,7	3.060
Shuma 1						<b>28,260</b>
Nr.	Tub HDPE 315 mm PN6	Çmimi i Ofertës (€)	Çmimi i korrigjuar (€)	Diferenca në Çmim (€)	Volumi i preventivit	Diferenca në vlerë (€)
1	h=2.5-3.0 m	77.9	71,18	6,7	84,8	570
2	h=3.0-3.5 m	81.7	74,82	6,9	243	1.671
3	h=3.5-4.0 m	84.7	77,43	7,3	16,3	118
3	h=> 4.0 m	100.4	91,84	8,6	174,3	1.493
Shuma 2						<b>3,852</b>
Nr.	Tub HDPE 400 mm PN6	Çmimi i Ofertës (€)	Çmimi i korrigjuar (€)	Diferenca në Çmim (€)	Volumi i preventivit	Diferenca në vlerë (€)
1	h=2.5-3.0 m	100	92,35	7,7	460,3	3.523
2	h=3.0-3.5 m	104.6	96,75	7,8	721,7	5.664
3	h=3.5-4.0 m	107.6	99,36	8,2	308	2.537
3	h=> 4.0 m	123.3	114,13	9,2	63	577
Shuma 3						<b>12,302</b>
Nr.	Tub HDPE 500 mm PN6	Çmimi i Ofertës (€)	Çmimi i korrigjuar (€)	Diferenca në Çmim (€)	Volumi i preventivit	Diferenca në vlerë (€)
1	h=2.5-3.0 m	124.3	115,62	8,7	199	1.728
2	h=3.0-3.5 m	129.2	120,31	8,9	102,4	910
3	h=3.5-4.0 m	132.2	122,92	9,3	83,5	775
3	h=> 4.0 m	144.4	134,34	10,1	75,6	761
Shuma 4						<b>4,174</b>
Nr.	Tub HDPE 630 mm PN6	Çmimi i Ofertës (€)	Çmimi i korrigjuar (€)	Diferenca në Çmim (€)	Volumi i preventivit	Diferenca në vlerë (€)
1	h=2.5-3.0 m	174.8	163,98	10,8	201	2.175
2	h=3.0-3.5 m	175	164,17	10,8	357,3	3.870
3	h=3.5-4.0 m	176.3	165,15	11,1	233,8	2.607
3	h=> 4.0 m	191.8	179,73	12,0	392,4	4.736
Shuma 5						<b>13,388</b>
SHUMA 1-5						<b>61,976</b>

- **Sqarim:** Diferencat e mësipërme kanë rezultuar nga korrigjimi i analizave të vetë kontraktorit duke korrigjuar çmimin e pagës orare nga 240 lekë/orë pune në 185 lekë/orë pune si dhe marzhin e fitimit nga 10 % në 5 %. Këto normativa janë marrë në bazë të punimeve të ngjashme të manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi sipas VKM nr. 629 datë 15.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” si dhe kontratës së sipërmarrjes së punimeve, konkretisht Kushteve të Veçanta të Kontratës, pika 1.2 Interpretime dhe pika 12.7 Vlerësimi.

- Për montimin e pusetave me material polipropileni çmimet për specialist+punëtori janë vlerësuar në masën 240 lekë/orë pune dhe jo 185 lekë/orë pune sa parashikon manuali teknik i çmimeve të punimeve të ndërtimit për këtë nënkategori të kostos. Gjithashtu, konstatohet se çmimet e zërave të mësipërm janë përlogaritur duke përfshirë një përfitim prej 10 %. Si rrjedhojë, duke bërë korrigjimet përkatëse rezultojnë se janë përdorur pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet fondet në shumën prej 18,069 €, e argumentuar kjo sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 7

Nr.	Puseta polipropileni, Tipi 1, d=250 mm	Çmimi i Ofertës	Çmimi i korrigjuar (€)	Diferenca në Çmim (€)	Diferenca në %	Volumi copë	Diferenca në vlerë (€)
-----	--	-----------------	------------------------	-----------------------	----------------	-------------	------------------------



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

		(€)					
1	h=2.5-3.0 m	2,140	2,032.5	107.5	45	4,837	2,032.5
2	h=3.0-3.5 m	2,365	2,247.9	117.0	33	3,862	2,247.9
3	h=3.5-4.0 m	2,488	2,365.7	122.2	11	1,345	2,365.7
4	h=> 4.0 m	2,602	2,474.9	127.0	8	1,017	2,474.9
Shuma 1							10,044
Nr.	Puseta polipropileni, Tipi 1, d=315 mm	Çmimi i Ofertës	Çmimi i korrigjuar	Diferenca në Çmim	Diferenca në %	Volumi	Diferenca në vlerë
1	h=2.5-3.0 m	2,562	2,437.9	124.0	4	496	2,437.9
2	h=3.0-3.5 m	2,769	2,635.1	133.8	5	669	2,635.1
3	h=3.5-4.0 m	3,026	2,880.9	145.0	1	145	2,880.9
4	h=> 4.0 m	3,402	3,241.0	160.9	4	644	3,241.0
Shuma 2							1,310
Nr.	Puseta polipropileni, Tipi 1, d=400 mm	Çmimi i Ofertës	Çmimi i korrigjuar	Diferenca në Çmim	Diferenca në %	Volumi	Diferenca në vlerë
1	h=2.5-3.0 m	3,391	3,230.50	160.5047718	12	1,926	3,230.50
2	h=3.0-3.5 m	3,579	3,410.53	168.470851	20	3,369	3,410.53
3	h=3.5-4.0 m	3,790	3,612.59	177.4115405	8	1,419	3,612.59
4	h=> 4.0 m	3,988	3,802.20	185.8014051	2	372	3,802.20
Shuma 3							6,715
SHUMA 1-3							18,069

- **Sqarim:** Diferencat e mësipërme kanë rezultuar nga korrigjimi i analizave të vetë kontraktorit duke ndryshuar pagën e punëtorisë/orë pune nga 240 në 185 dhe fitimin e sipërmarrësit nga 10 % në 5 % Këto normativa janë marrë në bazë të punimeve të ngjashme të manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi sipas VKM nr. 629 datë 15.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” si dhe referuar kontratës së sipërmarrjes, konkretisht Kushteve të Veçanta të Kontratës, pikës 1.2 Interpretime dhe pika 12.7 Vlerësimi.

#### Urdhri i ndryshimit nr. 6

Konstatohet se janë ofertuar nga ana e kontraktorit dhe më pas miratuar nga palët 4 kategori punimesh si më poshtë:

- Rinovimi i tubit hyrës HDPE 1200 – 80,863.27 €;
- Sistemimi i linjës hyrëse ekzistuese të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura – 7,468.00 €;
- Rinovimi i tubit hyrës në stacionin e pompimit nr. 1 – 140,660.32 €;
- Zëvendësimi i tubit të ngritjes në stacionin e pompimit nr. 1 – 120,656.59 €;

Kostoja totale e tyre është dhënë si më poshtë:

Tabela nr. 8

Nr.	Emërtimit	Vlera
1	Rinovimi i tubit hyrës HDPE 1200	80,863.27 €
2	Sistemimi i linjës hyrëse ekzistuese të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura	7,468.00 €
3	Rinovimi i tubit hyrës në stacionin e pompimit nr. 1	140,660.32 €
4	Zëvendësimi i tubit të ngritjes në stacionin e pompimit nr. 1	120,656.59 €
<b>TOTAL</b>		<b>349,648.18 €</b>

Për këto zëra janë marrë oferta për zërat si më poshtë:

- Furnizim vendosje e tubit HDPE 1200 mm, çmimi i pranuar i blerjes 216.5 €/ml dhe ai i furnizim vendosjes 335.23 €/ml;

Lidhur me këtë zë konstatohet se është përlloritur në mënyrë të gabuar analiza e kostos pasi fitimi i sipërmarrësit për punimet e ndërtimit përlloritet në përqindje në bazë të shpenzimeve të



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

përgjithshme dhe jo në bazë të shpenzimeve të përgjithshme + shpenzimeve plotësuese. Gjithashtu sipas manualit teknik të çmimeve në fuqi paga orare është 185 lekë/orë pune dhe jo 1.85 €/orë pune dhe çmimi i autovinçit referuar po këtij manuali është 2800 lekë/orë pune (21 €/orë pune). Duke bërë korrigjimet edhe për efekt të pasqyrimin të fitimit 10 % dhe jo 5 % sa është parashikuar në pikën 1.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës rezulton se është rritur me 23.33 €/ml çmimi i tubit e si rrjedhojë janë përdorur pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet fondet në shumën prej **793.22 €** vetëm për këtë zë.

- Furnizim vendosje e bashkueseve për tubat, çmimi i pranuar i blerjes 2,250 €/ml dhe ai i furnizim vendosjes 2,799.49 €/ml;

Lidhur me këtë zë konstatohet se është përlogaritur në mënyrë të gabuar analiza e kostos pasi fitimi i sipërmarrësit për punimet e ndërtimit përlogaritet në përqindje në bazë të shpenzimeve të përgjithshme dhe jo në bazë të shpenzimeve të përgjithshme + shpenzimeve plotësuese. Gjithashtu sipas manualit teknik të çmimeve në fuqi paga orare është 185 lekë/orë pune dhe jo 1.85 €/orë pune. Duke bërë korrigjimet edhe për efekt të pasqyrimin të fitimit 10 % dhe jo 5 % sa është parashikuar në pikën 1.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës rezulton se është rritur me 138.7 €/ml çmimi i materialit e si rrjedhojë janë përdorur pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet fondet në shumën prej **277.4 €** vetëm për këtë zë.

- Furnizim vendosje e penstock-ut, çmimi i pranuar i blerjes 11,250 €/ml dhe ai i furnizim vendosjes 13,991.38 €/ml;

Lidhur me këtë zë konstatohet se është përlogaritur në mënyrë të gabuar analiza e kostos pasi fitimi i sipërmarrësit për punimet e ndërtimit përlogaritet në përqindje vetëm në bazë të shpenzimeve të përgjithshme dhe jo në bazë të shpenzimeve të përgjithshme + shpenzimeve plotësuese. Gjithashtu sipas manualit teknik të çmimeve në fuqi paga orare është 185 lekë/orë pune dhe jo 1.85 €/orë pune dhe çmimi i autovinçit referuar po këtij manuali është 2800 lekë/orë pune (21 €/orë pune). Duke bërë edhe për efekt të pasqyrimin të fitimit 10 % dhe jo 5 % sa është parashikuar në pikën 1.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës korrigjimet rezulton se është rritur me 873.13 €/ml çmimi i këtij zëri e si rrjedhojë janë përdorur pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet fondet në shumën prej **873.13 €** vetëm për këtë zë.

- Furnizim vendosje e ekranit automatik të mbeturinave, çmimi i pranuar i blerjes 77,4000 €/ml dhe ai i furnizim vendosjes 98,026.13 €/ml;

Konstatohet se analiza e kostos së blerjes, transportimit dhe vendosjes në vend e ekranit automatik të mbeturinave me vlerë 98,026.13 € është bërë njësojë si për punimet e ndërtimit në bazë të manualit teknik të çmimeve duke përlogaritur një kosto si më poshtë:

Tabela nr. 9

Furnizim dhe instalim i krehër automatik të mbeturinave	copë	Punëtori			Transport			Makineri			Materiale		
		3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	2												
				3 x 4			6 x 7			9 x 10			12 x 13
Sp + p	op	400	1.85	740									
Sigurime shoqërore 16.7%	€	740	0.17	123.58									
Transport nga Venecia, Itali	€				1,110	3	3,330						
Vinç	op							23	40	920			
Ekranit automatik i mbeturinave	copë										1	77,400	77,400
<b>Shuma :</b>				<b>863.58</b>			<b>3,300</b>			<b>920</b>			<b>77,400</b>

Shpenzimet e	Shpenzimet e	Fitimi	Çmimi
--------------	--------------	--------	-------



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SE, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

Drejtëpërdrejta	Plotësuese		
15	16	17	18
5+8+11	8 % x 55	10 % x (15+16)	15+16+17
<b>82,513.58</b>	<b>6,601.09</b>	<b>8,911.47</b>	<b>98,026.13</b>

Në fakt, duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme me rastin e përmendur më sipër për dragën lundruese kjo përllogaritje është e gabuar si dhe duke bërë korrigjimet për pagën e punëtorisë nga 1.85 €/ orë pune në 1.34 €/orë pune, pagën për orë pune të vinçit nga 40 €/orë pune në 21 €/orë pune dhe korrigjimit për efekt të pasqyrimin të fitimit 10 % dhe jo 5 % sa është parashikuar në pikën 1.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës vlera me të cilën duhet të ishte pranuar ky zë është si më poshtë:

Tabela nr. 10

Furnizim dhe instalim i ekranit automatik të mbeturinave	copë	Punëtori			Transport			Makineri			Materiale		
		3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	2			3 x 4			6 x 7			9 x 10			12 x 13
Sp + p	op	400	1.34	536									
Sigurime shoqërore 16.7%	€	536	0.17	89.51									
Transport nga Venecia, Itali	€				1,110	3	3,330						
Vinç	op							23	21	483			
Ekranit automatik i mbeturinave	copë												
<b>Shuma :</b>				<b>625.51</b>			<b>3,300</b>			<b>483</b>			-

Shpenzimet e Drejtëpërdrejta	Shpenzimet e Plotësuese	Fitimi	Çmimi i montimit	Çmimi i ekranit	Çmimi total
15	16	17	18	19	20
5+8+11	50 % x 5	5 % x (15+16)	15+16+17		18+ 19
<b>4,875.51</b>	<b>312.75</b>	<b>259.41</b>	<b>5447.67</b>	<b>77,400</b>	<b>82,847.67</b>

Pra çmimi i korrigjuar është 82,847.67 €. Diferenca prej 15,179.22 € përfaqëson një përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve.

- Furnizim dhe vendosje e tubacionit të çelikut me DN 400 PN 10 (përfshirë flaxhat elementët shtesë), çmimi i pranuar i blerjes 92,289 €/copë dhe ai i furnizim vendosjes 117,532.59 €/copë;

Konstatohet se analiza e koston së blerjes, transportimit dhe vendosjes në vend e tubit të çelikut me diametër DN400 mm PN10, L=51.4, 4 pcs me vlerë 117,532.59 € është bërë si më poshtë:

Tabela nr. 11

Furnizim dhe vendosje e tubacionit të çelikut me DN 400 PN 10	copë	Punëtori			Transport			Makineri			Materiale		
		3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	2			3 x 4			6 x 7			9 x 10			12 x 13
Sp + p	op	576	1.85	1,065.6									
Sigurime shoqërore 16.7%	€	1,065.6	0.167	177.96									
Transport nga Venecia, Itali	€				1	1,800	1,800						
Vinç	op							72	50	3,600			
Furnizim tub	set										1	92,289.6	92,289.6



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SE, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

çeliku DN 400 PN 10													
<b>Shuma :</b>				<b>1,243.56</b>			<b>1,800</b>			<b>3,600</b>			<b>92,289.6</b>

Shpenzimet e Drejtpërdrejta	Shpenzimet e Plotësuese	Fitimi	Çmimi
15	16	17	18
5+8+11	8 % x 15	10 % x 16	15+16+17
<b>98,933.16</b>	<b>7,914.65</b>	<b>10,684.78</b>	<b>117,532.59</b>

Në fakt në analizën e mësipërme rezulton se nuk janë pasqyruar në përputhje me manualin teknik të çmimeve në fuqi:

- çmimi i pagës orare për punëtorinë i cili duhet 1.34 €/orë pune dhe jo 1.85 €/orë pune;
- çmimi i pagës orare për vinçin i cili duhet 23 €/orë pune dhe jo 50 €/orë pune;
- fitimi i sipërmarrësit i cili është përlogaritur 10 % dhe jo 5 %;

Nga studimi i analizës së kostos konstatohet se ka një mospërputhje mes volumit për të cilin është marrë oferta për tubacionin e çelikut dhe elementëve shtesë dhe volumit të pasqyruar në preventiv, në pagesën pjesore IPC dhe vizatimeve të As-Builtëve. Konkretisht rezulton se ofertat nga operatorët e ndryshëm në treg janë marrë për gjatësi të tubit të çelikut prej 54 ml. Nga këto oferta, është përdorur në hartimin e analizës së kostos vlera më e ulët e ofertave të marra, pra ajo me vlerë 92,289.6 €/54 ml tub çeliku. Në fakt, zërit në preventivin e miratuar nga palët, dhe pagesës pjesore si dhe vizatimeve As-Built rezulton se është kryer gjatësia prej 51.6 ml, ose 2.4 ml më pak (5 %). Për rrjedhojë duke bërë korrigjimet për çmimet jashtë manualit dhe diferencës në volum të kryer më pak nga çmimi për të cilin është ofertuar rezulton se vlera me të cilën duhet të ishte pranuar ky zë është si më poshtë:

Tabela nr. 12

Furnizim dhe vendosje e tubacionit të çelikut me DN 400 PN 10	copë	Punëtori			Transport			Makineri			Materiale		
		3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	2			3 x 4			6 x 7			9 x 10			12 x 13
Sp + p	op	576	1.35	771.84									
Sigurime shoqërore 16.7%	€	771.84	0.167	128.9									
Transport nga Venecia, Itali	€				1	1,800	1,800						
Vinç	op							72	23	1,650			
Furnizim tub çeliku DN 400 PN 10	set										1	87,846.03	87,846.03
<b>Shuma :</b>				<b>900.74</b>			<b>1,800</b>			<b>1,656</b>			<b>88,187.84</b>

Shpenzimet e Drejtpërdrejta	Shpenzimet e Plotësuese	Fitimi	Çmimi
15	16	17	18
5+8+11	8 % x 15	5 % x 16	15+16+17
<b>92,544.58</b>	<b>7,403.57</b>	<b>4,627.23</b>	<b>104,575.38</b>

Pra çmimi i korrigjuar është 104,575.38 €. Diferenca prej 12,957.21 € përfaqëson një përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve.

Urdhri i ndryshimit nr. 9

Ky Urdhër Ndryshimi parashikon rialokimin e fondeve nga rezervat e Lotit 1 dhe Lotit 2 si dhe nga diferenca e pa përdorur e Lotit 2 për të instaluar një ndalues për akumulimin e rërës që vjen



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

prej rrjetit të kanalizimit. Konstatohet se analizat e zërave për realizimin e këtij Urdhër Ndryshimi nuk janë pasqyruar në përputhje me manualin teknik të çmimeve në fuqi, konkretisht:

- çmimi i pagës orare për punëtorinë i cili duhet 1.34 €/orë pune dhe jo 1.85 €/orë pune;
- në të gjitha rastet çmimi i punëtorisë nuk është përlogaritur së bashku me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;

Duke bërë korrigjimet përkatëse rezultojnë diferencat si më poshtë:

Tabela nr. 13

Nr. analize	Emërtimi i zërit	Çmimi i ofertuar (€)	Çmimi i korrigjuar (€)	Diferenca në çmim (€)	Sasia	Diferenca në vlerë (€)
5.1	Furnizim vendosje ndarës rëre 60 m <sup>3</sup> /h	39,382	37,384	1,998	1	1,998
5.1	Furnizim vendosje marrëse rëre me rrota	3,680	3,501	179	1	179
5.3	Furnizim vendosje ventilator ajri dhe largim rëre	7,613	7,283	639	2	1,278
5.4	Furnizim vendosje tub DN 40 për ujë industrial dhe ajër të freskët	470	397	73	2	146
5.5	Furnizim vendosje tub DN 63 për ajër të pastër nga ventilatori dhe largim rëre sipas vizatimeve	1,414	1,194	22	1	220
5.6	Ndërhyrje në fund të sistemit të ngritjes së ajrit	113	71	42	2	84
<b>SHUMA</b>						<b>3,905</b>

Diferenca prej 3,905 € përfaqëson një përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve.

**Kriteri:**

- Kontratën e shërbimit me objekt “*Supervizimi i ndërtimit të rrjetit të kanalizimit në Vlorë, faza II*” lidhur sipas asaj me nr. EuropeAid/136786/DH/SER/AL me numër identifikimi AL/IPA2012/04 e cila ka hyrë në fuqi me datë 03.12.2015, konkretisht artikulli 7 *Obligimet e Kontraktorit* tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës Aneksi I;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Punimeve me nr. AL/IPA2012/05 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Pika 13.3 *Procedurat e Ndryshimeve*, paragrafi i fundit ku përcaktohet se:

“*Pas udhëzimit ose aprovimit të një Urdhër Ndryshimi (Variation Order), Inxhinieri duhet të vazhdojë në përputhje me nën-klauzolën 3.5 [Përcaktimet] për të rënë dakord ose për të përcaktuar rregullimet në Çmimin e Kontratës dhe Skedulit e Pagesave. Këto rregullime duhet të përfshijnë **futimin e arsyeshëm**, dhe duhet të marrin në konsideratë pranimin e kontraktorit sipas Nën-Klauzolës 13.2 [Value Engineering], nëse është e aplikueshme”;*

- Kushteve të Veçanta të Kontratës:
  - pika 1.2 *Interpretime* në të cilin këtij paragrafi i është shtuar një formulim ku përcaktohet se:

“*Në këto Kushte (duke i ‘u referuar Kushteve të Përgjithshme të Kontratës), parashikimet që përfshijnë shprehjen **Kosto plus futim i arsyeshëm** kërkojnë që ky futim të jetë 1/20 (5 %) e kostove”*

- pika 1.4 *Ligji dhe Gjuha* ku përcaktohet se:



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

- *‘Ligji i aplikueshëm për zbatimin e projektit i cili është subjekti i kësaj kontrate do të jetë ligji i Republikës së Shqipërisë’;*

- pika 12.7 Vlerësimi paragrafi i fundit ku përcaktohet se:

*‘Nëse nuk ka norma ose çmime të përshtatshme për nxjerrjen e një norme të re ose çmimi, ai do të rrjedhë nga Kostoja e arsyeshme e ekzekutimit të punës, së bashku me fitim të arsyeshëm, duke marrë parasysh çdo çështje tjetër të lidhur’;*

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

Neni 1: Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve për objektet në Republikën e Shqipërisë kontrollohen dhe dispiplinohen në bazë të dispozitave të këtij ligji;

Neni 2: Ky ligj zbatohet për të gjitha projektimet dhe zbatimet e punimeve të ndërtimit që realizohen nga persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Neni 3: Në kuptim të këtij ligji, nëse nuk përcaktohet ndryshe punime ndërtimi quhen të gjitha punimet e ndërtimit për ndërtesat, objektet qytetare, veprat industriale, të infrastrukturës dhe për objektet e tjera

Neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”

- VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;

- Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”

- Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I, germa A, paragrafi i fundit ku përcaktohet se:

*“Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat”*

si dhe Kreu II, Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit

- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, ku përcaktohet se:

Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”

Pika 8.3: “Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë”

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

*“3.2 Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e*

*saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

*3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara*



**KONTROLI I LARTË I SHITIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

*çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”*

- VKM nr. 23 datë 12.01.2011 “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), Komponenti I : Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional”, Pikat 8, 9 dhe Pika 11, germa b, paragrafi i;
  - Marrëveshjet Operacionale, përkatësisht të hyra në fuqi në datë 06.08.2015, 28.06.2016 dhe në datë 05.02.2018:
    - ❖ Artikulli 6 Përgjegjësitë e Zyrtarit të Lartë të Programit, nënartikujt Implementimi dhe Monitorimi, paragrafi i parë pas paragrafit me germën i të këtij Artikulli,
    - ❖ Artikulli 4 Përgjegjësitë e Zyrtarit Autorizues të Programit, në veçanti nënartikulli e) Pagesat, paragrafi i parë dhe i tretë ku përcaktohet se:
- “PAO, do të kryejë këto kryejë detyra si vijon:
- Kryerjen e pagesave vetëm për kostot e pranueshme për secilën kontratë në bazë të Programit Kombëtar TAIB dhe në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes përkatëse të Financimit dhe kontratës në fuqi, kundrejt faturave / kërkesave për pagesa të lëshuara nga kontraktori/përfituesi i grantit;
  - Kontrolli i legjitimitetit dhe saktësisë së kërkesave për pagesa/fatura dhe përputhshmëria me dispozitat e kontratës”;
  - ❖ Artikulli 16 ‘Pagesat’, pika 2 ku përcaktohet se:
    - “CFCU do të bëjë pagesa vetëm kundrejt kontratave të nënshkruara të miratuara nga EUD në përputhje me Udhëzuesin e fundit Praktik për Procedurat e Kontratave për Veprimet e Jashtme të BE-së; pas një kontrolli të detajuar të përputhshmërisë së faturave / kërkesave për pagesa me kontratat me të cilat ato lidhen, dhe pasi të keni marrë nga SPO një aprovim të dokumenteve teknike dhe dorëzimeve të paraqitura nga kontraktuesi”;
  - ❖ Artikulli 17 ‘Parregullsitë dhe rikuperimi i shumave të paguara gabimisht’ ku përcaktohet se:
    - “SPO është përgjegjës për ushtrimin e kontroleve përkatëse, në nivelin e tij/saj të operacioneve, për të siguruar parandalimin e parregullsive”;
- Marrëveshjen Operacionale për projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II”, të lidhur në qershor 2016 mes Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Financimit dhe Kontraktimit të Fondeve të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë, në rolin e Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO) në cilësinë e ‘punëdhënësit’, përfaqësuesit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO) si dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës Kanalizime, në cilësinë e ‘përfituesit’, konkretisht Artikulli 1, , Artikulli 3, 4 dhe Artikulli 5.
  - Manualin e Brendshëm të Procedurave të CFCU, konkretisht:



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

- Seksioni C *Menaxhimi dhe Organizimi*, Kapitulli 3.4 *Detyrat e CFCU*, nënkapitulli 3.4.6 *Pagesat e Kontratave ku përcaktohet se:*
  - **Kontrolli i legjitimitetit dhe saktësisë së kërkesave për pagesa/fatura dhe përputhshmëria me dispozitat e kontratës**”;
  - *Kryerjen e pagesave vetëm për kostot e pranueshme për secilën kontratë në bazë të Programit Kombëtar TAIB dhe në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes përkatëse të Financimit dhe kontratës në fuqi, kundrejt faturave / kërkesave për pagesa të lëshuara nga kontraktori/përfituesi i grantit;*
- Seksioni D *Burimet Njerëzore*, Aneksi 1 *Përshkrimi i punës*, PAO Drejtuesi i CFCU;
- Seksioni D *Burimet Njerëzore*, Aneksi 1 *Përshkrimi i punës*, Specialist Kontrate;

**Ndikimi/Efekti:** Përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet i fondeve në shumën prej **156,557 €**.

**Shkaku:** Mos reflektim i saktë kushteve të kontratës.

**Rëndësia:** E lartë.

**1.1 Rekomandim:** Të merren masa nga CFCU në rolin e Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO), Zyrtarit i Lartë të Programit (SPO), Përfituesi dhe Koordinatori Kombëtar i Instrumentit të Parazgjerimit (NIPAC) që në vazhdimësi, të sigurohet një zbatim korrekt dhe me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet i kontratave me fonde nga BE, Bankës Botërore dhe donatorëve të tjerë me qëllim maksimizimin e përfitimit nga Shteti Shqiptar prej këtyre fondeve. *Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi supervizori i punimeve “D... & ...G” me përfaqësues ligjor z. W. M., z. K. K., znj. A. T. dhe z. G. K., të tre këta në rolin e Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO), z. A. A. dhe z. K. B., të dy këta në rolin e IPA Koordinator, përkatësisht pranë DPUK dhe AKUK (i njëjti institucion), z. M. S. dhe znj. E. K., të dy këta në rolin e Zyrtarit të Lartë të Programit (PAO) dhe znj. O. D., në cilësinë e specialistit pranë Sektorit të Menaxhimit të Kontratave.*

**Për sa më sipër, janë bërë observacione nga palët e përfshira në problemet e konstatuara, nga të cilat është marrë në konsideratë vetëm observacioni i bërë nga supervizori i punimeve lidhur me zërin “Shtresë gjeotekstil e detajuar si në figurë” pasi observacionet e tjera nuk sjellin fakte shtesë dhe nuk i përmbahen konstatimeve por vetëm përgjegjësisë personale të secilit.**

**b. Titulli i Gjetjes:** Projekti i zbatimit “*Ndërtimit i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II*”: nuk ka realizuar objektivat e kontratës së nënshkruar: Përmirësimi i mjedisit, kushteve të jetesës dhe shëndetit të popullsisë në Vlorë në përputhje me Standardet Evropiane në lidhje me cilësinë e ujit dhe menaxhimin e humbjeve, rehabilitimin dhe zgjerimin e impiantit ekzistues për trajtimin e ujërave të ndotura në Bashkinë Vlorë.

**Situata:** Kanalizimet e qytetit të Vlorë nuk janë funksionale në masën e projektuar, 90 % e popullatës së qytetit nuk ka pasur (e nuk ka deri sot) qasje në kanalizimet publike deri në vitin 2017. Zbatimi i projektit të sipërcituar ka përfunduar pa u realizuar faza e fundit e sistemit të përpunimit të ujërave të ndotura.



**KONTROLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

**Kriteri:** Kontrata dhe elementet kyç të programit, objektivat, zgjedhja e projektit, lidhja me strategjitë kombëtare dhe koordinimi me asistencën e donatorëve, sinergjia midis strukturave të përcaktuara për projektimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programimit të IPA-s 2012 “Ndërtimit i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II”.

**Ndikimi/Efekti:** Objektivi i projektit nuk është realizuar e ITUN funksionon vetëm për largimin e mbetjeve mekanike dhe yndyrat/vajrat nga ujërat e ndotura dhe jo nga elementët kimik (amoniak, fosfor, azot etj.) dhe bakteriologjik që janë problemi kryesor i ndotjes së ujërave që derdhen në det. Zgjerimi i kanalizimit në kufijtë administrative në Bashkinë Vlorë është realizuar vetëm 80% kur është parashikuar 90% e popullsisë në kufijtë e bashkisë. Moszbatimi i punimeve sipas qëllimit të realizimit të projektit në Impiantin e Trajtit të Ujërave të Ndotur në Vlorë ka sjellë ndërprerjen e pagesave nga Delegacioni i BE për projektin IPA 2012, pasi qeveria nuk ka arritur të sigurojë qëndrueshmërinë afatgjate të investimit.

**Shkaku:** Mungon monitorimi në vijueshmëri nga faza e projektimit deri në implementimin e projektit nga strukturat e personat përgjegjës. Është sipërfaqësor komunikimi dhe koordinimi brenda administratës qendrore, përfituesit sipas marrëveshjes (DPUK/AKUK) e përfituesit përfundimtar (Bashkia Vlorë dhe UKV), nuk janë zbatuar kushteve e kontratës nga kontraktori.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Strukturat qeveritare të ngarkuara për programimin dhe zbatimin e fondeve IPA; CFCU në rolin e Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO), Zyrtarit i Lartë të Programit (SPO), AKUM në rolin e Përfituesit, Koordinatori Kombëtar i Instrumentit të Para zgjerimit (NIPAC) dhe UKV duhet të bëjnë më shumë përpjekje për mbikëqyrjen e procesit nga faza e programimit dhe përgatitjes buxhetore, në fazat e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit. Është e domosdoshme që të përmirësohen kapacitetet e strukturave përgjegjëse dhe koordinimi më i mirë midis institucionet për zbatimin Koordinim më i mirë midis këtyre institucioneve.

*Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me Marrëveshjen Operacionale, dhe përcaktimet e pikës 3, neni 6 të, pikave 1 e 2 të nenit 7, nenit 8 Seksioni II dhe nenit 9, Seksioni III i ligjit nr.9840, datë 10.12.2007 Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër ndërmjet këshillit të ministrave të republikës së Shqipërisë dhe komisionit të komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të Para zgjerimit (IPA)”, neneve 2 e 7 të Shtojcës II “Kushtet e Përgjithshme” e VKM nr. 23, datë 12.01.2011“Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së bashkimit evropian në kuadër të instrumentit të Para zgjerimit (IPA), komponenti i: Asistenca e tranzicionit dhe forcimi institucional” ngarkohen me përgjegjësi: znj. E. K., znj. A. T., z. K. K., z. M. S., znj. A. T., z. A. A., K. B..*

**c. Titulli i Gjetjes:** Projekti i zbatimit të punimeve: “Ndërtimit i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” Lotin 1: (varianti 2 dhe 4), janë projekte që nuk plotësojnë kushtin që financimi në ITUN të jetë përfundimtar për funksionimin e impiantit. Variantet e përzgjedhura nuk kanë marrë në konsideratë ndikimin në mjedis sipas legjislacionit shqiptar dhe Standardeve Evropiane. **Situata:** Në ndërtimin/funksionimin e Impiantit të përpunimit të ujërave të ndotura nuk (është pa Leje Mjedisore) është marrë në konsideratë detyrimi ligjor, Standardeve Evropiane dhe kushtet e kontratës.



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

**Kriteri:** Nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Kreun III, Kreun IV e Kreun V të VKM nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, Standardet Evropiane dhe pikën 2.4 “Çështjet ndërsektoriale” të aneksit Aneksi A, “Programi kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e komponentit IPA për asistencën dhe forcimin institucional për vitin 2012”.

**Ndikimi/Efekti:** Funksionimi i ITUN, nuk ka arritur që cilësia e ujit që derdhet në gjirin e Vlorës të përmirësohet në mënyrë të qëndrueshme, cilësia e ujit që derdhet pas përpunimit nuk i përgjigjet Standardeve Evropiane të funksionimi i Impiantit e nuk është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

**Shkaku:** Nënshkrimi i marrëveshjes financiare të projektit IPA 2012 me objekt: “Ndërtimit i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” është nënshkruar pa një studim të hollësishëm fizibiliteti. Nuk është bërë inventarizimi i gjendjes reale në impiant si parakusht për përlogaritjen e volumeve të punimeve për shmangien e mbivendosje të zërave e volumeve të punimeve (pajisjeve e makinerive) të realizuar më parë. Nuk është realizuar një plan monitorimi i projektit midis autoriteteve të menaxhimit të centralizuar të asistencës së BE në kuadër të IPA dhe UKV e Bashkisë Vlorë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Autoritetet e menaxhimit të projekteve në bashkëpunim me institucionet përfituese, duhet të përgatisin në sinergji prioritete, studimet e fizibilitetit, projektet dhe implementimin e punimeve të miratuara sipas marrëveshjeve. Planifikimi duhet të përfshijë veprimet/masat, afatin final, buxhetin e vlerësuar, institucionin përgjegjës për buxhetin, institucionin përgjegjës për veprimet implementuese, institucionin përgjegjës për koordinimin e veprimeve.

*Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me Nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Kreun III, Kreun IV e Kreun V të VKM nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, Standardet Evropiane dhe pikën 2.4 “Çështjet ndërsektoriale” të aneksit Aneksi A, “Programi kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e komponentit IPA për asistencën dhe forcimin institucional për vitin 2012” ngarkohen me përgjegjësi njësisia e CFCU e në rolin e Autoritetit Kontraktor.*

**d. Titulli i Gjetjes:** Nuk është siguruar kapaciteti absorbues i autoriteteve të menaxhimit të Instrumentit të Para zgjerimit, rritja e kapaciteteve institucionale, forcimi i strukturave, sistemeve dhe burimeve njerëzore. Trajnimet e kryera për punonjësit e ITUN janë minimale.

**Kriteri:** Rezultati 1 i Aneksit 1 dhe Pika 2.5 e Aneksit 2 të Programit Kombëtar për Shqipërinë nën ndihmën tranzitore IPA dhe komponenti i ndërtimit institucional për 2012 (menaxhimi i decentralizuar). Fondet IPA janë alokuar kryesisht dhe në funksion të rritjes së kapaciteteve institucionale, në terma të forcimit të strukturave, sistemeve dhe burimeve njerëzore.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e burimeve njerëzore të mirë-trajnuar për funksionimin optimal të ITUN dhe identifikimin/riparimin e avarive (për shkak të procedurat e rekrutimit të stafit i dhe largimi i stafit nga puna);

**Shkaku:** Informacion i limituar nga ana e nivelit të lartë drejtues të institucionit përfitues UKV e Bashkia Vlorë lidhur me programimin dhe zbatimin e fondeve IPA. Mungesa e politikave për të



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BESË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

motivuar stafin. Nga stafi i Ujësjetllës Vlorë janë trajnuar vetëm tre punonjës dy herë, kur sipas aneksit të kontratës do të trajnohej stafi si të veprojë me sistemin e kanalizimeve.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Qeveria shqiptare të sigurojë ndihmë politike të vazhdueshme për implementimin e programeve paraaduese në mënyrë që të garantojë se:

- Koordinimi mes Ministrive të linjës dhe institucioneve lokale është i përshtatshëm mes mekanizmave inter-institucional për programimin dhe implementimin e IPA duke alokuar burimet e nevojshme që përfshijnë kosto të funksionimit dhe të mirëmbajtjes;
- Qëndrueshmërinë afatgjatë të investimit;
- Nëpunësit civil të trajnuar për menaxhimin e fondeve IPA të qëndrojnë në funksionet e tyre, pavarësisht ndryshimeve politike të vendit;
- Institucionet përfituese të kenë burimet e duhura njerëzore, financiare dhe materiale në mënyrë që mbështetja financiare evropiane të mund të përdoret me sa më shumë efikasitet;
- Institucionet përfituese do të organizojnë, përzgjedhin dhe të caktojnë anëtarë të grupeve të punës, të drejtojnë, monitorojnë dhe koordinojnë komitete dhe seminare siç kërkohet nga aktivitetet e projektit.

*Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me rezultatin 1 të Aneksit 1 dhe Pika 2.5 e Aneksit 2 të Programit Kombëtar për Shqipërinë nën ndihmën tranzitore IPA dhe komponenti i ndërtimit institucional për 2012 (menaxhimi i decentralizuar) ngarkohen me përgjegjësi njësia e CFCU e në rolin e Autoritetit Kontraktor dhe Qeveria Shqiptare.*

**4. Komunikimet zyrtare në lidhje me përfitimet konkrete, opinionet e dhëna për draft raportet e paraqitura nga menaxhimi i projektit, apo dakordësitë mbi to. Marrja në dorëzim e përfitimeve konform kuadrit rregullator në fuqi, regjistrimet kontabël në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare në vitet koherente të përfitimit. Efektiviteti i përfitimeve konkrete, krahasuar me objektivat kryesorë të përcaktuara në kuadër të implementimit të IPA 2012 për përfituesin**

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- *Komunikimet zyrtare të mbajtura në kuadër të zbatimit të kontratave të projektit që përshijnë punimet dhe mbikëqyrjen e projektit të ndërtimit të sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza II, pjesë e IPA 2012;*
- 2- *Opinionet e miratimet e raportimeve të Kontraktorëve;*
- 3- *Marrja në dorëzim e përfitimeve nëpërmjet certifikatave të marrjes në dorëzim, regjistrimet kontabël dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare në vitet koherente të përfitimit;*
- 4- *U auditua efektiviteti i përfitimeve konkrete si dhe efektiviteti i mekanizmave të parashikuar që adresojnë qëndrueshmërinë e projektit.*

**a. Titulli i Gjetjes:** Komunikimet me përfituesin final të projektit *Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II*, Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Vlorë, janë zhvilluar vetëm në fazën operacionale të projektit, pra kur ka përfunduar ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotur (ITUN) Vlorë, duke sjellë si pasojë që ITUN Vlorë të mos projektohet, llogaritet e zbatohet për një rrjet të



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

kombinuar të ujërave të bardha me atë të ujërave të zeza, siç edhe është faktikisht rrjeti i kanalizimeve të qytetit të Vlorës duke shkaktuar kështu shfaqjen e problemeve gjatë fazës së operimit.

**Situata:**

Komunikimet zyrtare të projektit janë bazuar në specifikimet e VKM nr. 23, datë 12.01.2011 *“Për Përcaktimin e Funksioneve, Përgjegjësi dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Autoriteteve të Strukturave të Menaxhimit të Decentralizuar të Asistencës së Bashkimit Evropian në Kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), Komponenti I: Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional”*, i ndryshuar si dhe Marrëveshjes Operacionale ndërmjet Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (NIPAC) dhe Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO), Drejtorisë së Përgjithshme për Financimin dhe Kontraktimin e Bashkimit Evropian, Banka Botërore dhe Fondet e tjera të Donatorëve CFCU dhe Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO) për Menaxhimin e Decentralizuar të Asistencës IPA në Shqipëri, 28.06.2016, të ndryshuar, ku janë përcaktuar përgjegjësitë dhe funksionet e organeve që përbëjnë Strukturën Operative (OS) për Komponentin I IPA, në veçanti NIPAC, mbështetur nga zyra e NIPAC, Zyrtari Autorizues (PAO) Njësia Qendrore Financiare dhe Kontraktuese (CFCU), duke vepruar në rolin e Agjencisë Zbatuese (IA), Zyrtari i Lartë i Programit (SPO), i mbështetur nga një Njësi IPA, Ministria e linjës ose ndonjë organ tjetër publik i përfshirë në menaxhimin e decentralizuar të projekteve financuar nga programi IPA përkatës.

Për të tre kontratat që përshijnë punimet, mbikëqyrjen dhe asistencën teknike të projektit të ndërtimit të sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza II, pjesë e IPA 2012, janë mbajtur komunikime të rregullta zyrtare në formë shkresore dhe me e-mail ndërmjet Agjencisë Implementuese të Projektit Njësia e CFCU, Drejtorisë së Përgjithshme të CFCU, në rolin e PAO (Zyrtari Autorizues i Programit), aktorëve të menaxhimit të implementimit, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtorisë së Integritit dhe Koordinimit e projekteve IPA, në rolin e SPO (Zyrtari i Lartë Autorizues) Drejtor i Përgjithshëm i DPUK e Koordinatorit të projekteve IPA në DPUK, si dhe kontraktorët përkatës për secilën prej kontratave të punimeve e konsulencave. Në komunikimet shkresore mes Autoritetit Kontraktor CFCU, Projekt Menaxherëve dhe Kontraktorëve, janë të cituar titulli i kontratës dhe numrin e identifikimit. Komunikimet janë të karakterit njoftues, pranues, miratues, certifikues ose në trajtë vendimi, gjithnjë bazuar në procedurën e specifikuar në secilën prej kontratave në lidhje me raportimin dhe miratimet përkatëse.

Linja kryesore e komunikimit të projektit përcakton se Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë është struktura përgjegjëse për zbatimin e projekteve dhe me cilësinë e Autoritetit Kontraktor është përgjegjëse për miratimin final të produkteve të kontratave. Në marrëveshjen operacionale të nënshkruar midis Zyrtarit Kombëtar Autorizues (Zëvendësministri i Financave), Zyrtarit Autorizues të Programit (Drejtori i CFCU) dhe Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO/Drejtori i Njësive IPA) në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, neni 6, Zyrtarit të Lartë të Programit, pika e) “Implementimi”



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

si dhe në Manualin e CFCU seksioni L, janë përcaktuar qartë përgjegjësitë e SPO për verifikimin, miratimin dhe implementimin teknik të projektit e miratimin e projekteve/produkteve të dërguara nga kontraktori. SPO si zyrtar i lartë i programit në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës dhe CFCU në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe njëkohësisht strukturë përgjegjëse për zbatimin e projektit, janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit dhe paraqitjen me korrektësi të kërkesave zyrtare pranë Zyrtarit Kombëtar Autorizues.

Nga verifikimi i komunikimeve zyrtare u konstatua se komunikimet me përfituesin final të projektit Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Vlorë janë zhvilluar vetëm në fazën operacionale të projektit dhe kanë të bëjnë me përcaktimin e stafit operues në ITUN për tu trajnuar si dhe me marrjen në dorëzim e regjistrimin e ITUN në asetet e UK sh.a. Vlorë.

**Kriteri:**

Sa më sipër është në kundërshtim me Pikën 2.6 ii) e Projekt Fishës së amendamentit nr. 2 të marrëveshjes së financimit *ku përcaktohet se:*

*Në të kaluarën, disa autoritete lokale nuk pranuan të merrnin pronësinë e investimeve. Për këtë arsye të gjithë përfituesit (Ujësjetllës Kanalizime Vlorë dhe Bashkia e Vlorës) duhet të përfshihen nga faza e hershme e përgatitjes së studimeve të fizibilitetit dhe përgatitjes së projekteve dhe gjithashtu gjatë zbatimit.*

Si edhe në kundërshtim të VKM nr. 23, datë 12.01.2011 “Për Përcaktimin e Funksioneve, Përgjegjësi dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Autoriteteve të Strukturave të Menaxhimit të Decentralizuar të Asistencës së Bashkimit Evropian në Kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), Komponenti I: Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional” e ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:**

ITUN Vlorë nuk është projektuar, llogaritur e zbatuar për një rrjet të kombinuar të ujërave të bardha me atë të ujërave të zeza, siç edhe është faktikisht rrjeti i kanalizimeve të qytetit të Vlorës si dhe të paraqesë probleme gjatë fazës së operimit si pasojë e sistemit të amortizuar të stacioneve të pompimit.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i Projekt Fishës së amendamentit nr. 2 të marrëveshjes së financimit dhe mos përmbushje e përgjegjësi të përcaktuara në VKM nr. 23, datë 12.01.2011, të ndryshuar.

**Rëndësia:**

E lartë.

**Rekomandime:**

Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë CFCU dhe për projektet e decentralizuara në kuadër të IPA 2012 të marrin masa në vazhdimësi për përfshirjen e të gjithë përfituesve, edhe atyre fundorë, që nga faza e hershme e përgatitjes së studimeve të fizibilitetit dhe përgatitjes së projekteve dhe gjithashtu gjatë zbatimit.

*Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. K. K., Drejtor i njësisë IPA, përfaqësues i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në rolin e Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO) për periudhën nga fillimi i kontratave deri në 25.04.2017, përgjegjës për programimin, implementimin dhe monitorimin e projekteve financuar nga Komponenti i IPA, z. M. S. në rolin e Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO) Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU), në Ministrinë e Financave për periudhën nga fillimi i kontratave deri në 17.04.2018, përgjegjëse*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

*për monitorimin operacional (në nivel projekti), dhe kontrollin e brendshëm bazuar në kërkesat e sistemit të Menaxhimit të Decentralizuar të IPA-s, si edhe z. A. A., Koordinatori IPA (DPUK) për periudhën nga fillimi i kontratave deri në 11.12.2017.*

Për sa më sipër, nga ana e z. K. K., ish SPO është paraqitur observacioni si më poshtë:

**1. Komentet dhe shpjegimet e subjektit:** “Jam caktuar SPO në Nëntor 2015 dhe gjatë periudhës së hartimit të ffishës së projektit dhe fazës së hershme të studimit të fizibilitetit nuk kam ushtruar këtë detyrë, ndaj edhe për rrjedhojë nuk mund të jem përgjegjës. Gjithashtu jam ngarkuar me përgjegjësi deri në datën 25.04.2017, ndërkohë që jam larguar nga pozicioni i Drejtorit të Projekteve të Huaja dhe rrjedhimisht si Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në muajin Nëntor 2016. Për sa më sipër konstatimi nuk qëndron”.

**1. Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Përgjegjësia e SPO konform VKM nr. 23, datë 12.01.2011 qëndron pikërisht në mos përfshirjen në proces të përfituesit final UK sha Vlorë për periudhën 2015-2017. Për sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Nga ana e CFCU është paraqitur observacioni si më poshtë:

**2. Komentet dhe shpjegimet e subjektit:** Roli dhe përgjegjësitë e CFCU si autoritet kontraktor janë përcaktuar në VKM nr. 23 datë 12.02.2012 si dhe në marrëveshjen operationale ndërmjet KKIPA, PAO dhe zyrtarit të lartë të programit të institucionit përfitues. CFCU-ja është përgjegjëse për procedurat e prokurimit, kontraktimit, monitorimit dhe menaxhimit financiar në nivel kontrate. Autoriteti kontraktor nuk është përfshirë asnjëherë në procedurat e programimit.

**2. Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Përgjegjësia e CFCU në këtë rast nuk ka të bëjë me fazën programuese të projektit po siç edhe është shprehur në rubrikën e përgjegjësive, CFCU mban përgjegjësi për monitorimin operacional (në nivel projekti), dhe kontrollin e brendshëm bazuar në kërkesat e sistemit të Menaxhimit të Decentralizuar të IPA-s. Në këtë kuadër rekomandimi për CFCU ka të bëjë me përfshirjen e të gjithë përfituesve, edhe atyre fundorë gjatë fazës së zbatimit të projekteve. Për sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

**b. Titulli i Gjetjes:** Nga rakordimi i datave të miratimit të urdhrin të ndryshimit (VO) nr. 9 dhe datës së dorëzimit të certifikatës së marrjes në dorëzim të punimeve të Lotit 1 për projektin ‘Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II’, rezulton se punimet e parashikuara për përmirësimin e pajisjes së bllokimit të rërës të përfshira në urdhrin e shërbimit nr. 9, në fakt janë realizuar përpara se ky urdher të miratohej.

**Situata:**

Gjatë periudhës së provës, në të cilën ITUN është bërë operacional është hasur problemi i hyrjes së rërës në impiant i shkaktuar si pasojë e shkarkimit të ujërave sipërfaqësore në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza. Problemi i hyrjes së rërës në sistem është adresuar nëpërmjet përmirësimit të pajisjes së bllokimit të rërës, sipas urdhrin të ndryshimeve (VO) nr. 09. **Datë 17.04.2018** me një vlerë 53,002 €. Punimet e Lotit 1 janë marrë në dorëzim, nëpërmjet Certifikatës së Marrjes në Dorëzim të paraqitur nga kontraktori në **datë 21.03.2018**, të miratuar nga Kontraktori, Mbikëqyrësi i Punimeve, Koordinatori IPA (AKUK), Drejtori dhe Projekt Menaxheri (CFCU) si dhe



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

SPO në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës. Vlera e punimeve të këtij loti bazuar në kontratë është 4,559,140.97 € ndërsa vlera e punimeve të përfunduara të këtij loti, duke përfshirë edhe kostot e 5 *Variation Orders* (urdhrat e ndryshimeve) që i referohen punimeve të Lotit 1, përkatësisht VO 3, 5, 6, 7 dhe 9 është 4,283,737.14 € pa TVSh. Nga krahasimi i datave të miratimit të urdhrit të ndryshimit (VO) nr. 9 dhe datës së dorëzimit të certifikatës së marrjes në dorëzim, rezulton se punimet e parashikuara për përmirësimin e pajisjes së bllokimit të rërës të përfshira në urdhrin e shërbimit nr. 9, në fakt janë realizuar përpara se ky urdhër të miratohej.

**Kriteri:**

Neni 8 i Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe Udhëzimi nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”

7. *Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij.*

7.1 *Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim të urdhëruar me shkrim nga investitori ose persona të autorizuar prej tij, që nuk ndryshon, në thelb, kushtet kryesore të projektit, të kontratës dhe nuk rrit vleftën e saj.*

**Ndikimi/Efekti:**

Sipërmarrësi ka ndryshuar projektin, ka realizuar punime dhe ka kërkuar certifikim të tyre, në kushtet që këto punime nuk kanë qenë të miratuara nga Autoriteti Kontraktor.

**Shkaku:**

Sa më sipër ka ndodhur si rezultat i mos zbatimit të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe Udhëzim nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

**Rëndësia:**

E mesme

**Rekomandime:**

Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) Koordinatori IPA (AKUK) dhe Agjencia Implementuese/CFCU, të marrin masa në vazhdimësi, për të lejuar zbatimin e ndryshimeve në projektet e decentralizuara në kuadër të IPA 2012, vetëm pas miratimeve paraprake nga autoritetet e mësipërme.

*Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi sipërmarrësi i punimeve “A...A” s.r.l dhe mbikëqyrësi i punimeve “D.....M” dega e shoqërisë së huaj në Shqipëri për kryerjen e ndryshimeve në projekt pa miratimin nga investitori, si edhe A. T., Drejtor i njësisë IPA, përfaqësues i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në rolin e Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO) për periudhën 25.04.2017 – 17.04.2018, K. B., Koordinator IPA (AKUM) për periudhën 11.12.2017 – 31.05.2019 dhe M. S. në rolin e Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO) Agjencia Implementuese/Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktive (CFCU) për periudhën nga fillimi i kontratave deri në 17.04.2018, për miratimin e urdhrit të ndryshimit (VO) nr. 9, pasi këto punime ishin kryer.*

Për sa më sipër, nga ana e z. K. B. është paraqitur observacioni si më poshtë:

**1. Komentet dhe shpjegimet e subjektit:** *“Kam marrë detyrën në Tetor 2017 dhe si koordinator i projektit nuk më janë deleguar detyra të posaçme nga Drejtori i Përgjithshëm i AKUK z. A. S. i, përveç detyrave që përcaktohen në rregulloren e funksionimit të AKUK, në këtë kuadër kam*



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

*koordinuar dhe raportuar pranë eprorit tim direkt z. A. S. për çështje që ka të bëjë me ecurinë e projektit, pasi roli i koordinatorit nuk është vendimmarrës apo aprovues”.*

*Ndryshimi nr. 9 u krye menjëherë sipas dakordësisë paraprake nga të gjitha palët për parandalimin e depozitimit të rërës në vaskën e dekantimit, e cila do të sillte edhe prishjen e proceseve të tjera teknologjike, pavarësisht vonesës së kontraktit në përpilimin e dokumentacionit mbështetës.*

**1. Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Pas komenteve të bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit sqaron se pas verifikimit të urdhrit të ndryshimeve (VO) nr. 9, Koordinator IPA (AKUM), ka firmosur në mbështetje të miratimit të këtij urdhri në 12.04.2018. Për sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Ndërsa nga CFCU është paraqitur observacioni si më poshtë:

**2. Komentet dhe shpjegimet e subjektit:** Për punimet e parashikuara për përmirësimin e paisjes së bllokimit të rërës ka patur një marrëveshje me dakordësi paraprake që të ndërmerrej një veprim i menjëhershëm në këtë situatë. Kjo dakordësi është arritur gjatë vizitave “on the spot”

**2. Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Neni 8 i Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe Udhëzimi nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” shprehet qartë se Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim **të urdhëruar me shkrim** nga investitori ose persona të autorizuar prej tij. Në këto kushte në mungesë të dokumentimit të nënshkrimit “on the spot” të kësaj dakordësie, komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

**c. Titulli i Gjetjes:** Kontraktori i punimeve të Lotit 1 për projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II”, “A....A” s.r.l, nuk ka zhvilluar apo paraqitur në Raportin e Testimeve asnjë test të lidhje me funksionimin e pajisjes së përmirësuar të bllokimit të rërës. Kontraktori gjithashtu nuk ka përbushur detyrimin e përgatitjes dhe dorëzimit të një raporti mujor për punët gjatë fazës operacionale ku përfshihen matjet e sakta ditore të hyrjes dhe cilësitë dhe sasitë e flukseve dalëse të impiantit.

**Situata:** Gjatë periudhës së provës, në të cilën ITUN është bërë operacional është hasur problemi i hyrjes së rërës në impiant i shkaktuar si pasojë e shkarkimit të ujërave sipërfaqësore në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza. Problemi i hyrjes së rërës në sistem është adresuar nëpërmjet Kontraktorit i cili nuk ka zhvilluar apo paraqitur në Raportin e Testimeve asnjë test në lidhje me funksionimin e pajisjes së përmirësuar. Në fazën operacionale të projektit, tek Kërkesat e Punëdhënësit të Volumit 3a, pika 6 e kontratës, në lidhje me përgatitjen dhe dorëzimin e një raporti mujor për punët gjatë fazës operacionale ku përfshihen matjet e sakta ditore të hyrjes dhe cilësitë dhe sasitë e flukseve dalëse të impiantit, duke përdorur mostra cilësore 24 orëshe dhe ku të përfshihen parametrat e dhënë BOD5, Solids Suspended, Amoniak, Total Azot, Totali Fosfori nga mostra që analizohen në një laborator të certifikuar miratuar nga inxhinieri dhe analiza që merren për 7 ditë në muaj.

**Kriteri:** Neni 12.1 i Kushteve të Veçanta të Kontratës si dhe Kërkesat e Punëdhënësit, Volumi 3a, pika 6 e kontratës së punimeve EURPEAID/136785/DH/SER/AL.

**Ndikimi/Efekti:** Efektiviteti i përmirësimit të pajisjes së bllokimit të rërës është i pa provuar dhe



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

në këto kushte duke patur prezent edhe faktin që rrejtji i ujërave të bardha në Vlorë është i kombinuar me atë të ujërave të zeza dhe që sasia e ujit që vjen në ITUN është mbi kapacitetin maksimal të parashikuar në projekt, ku për shkak të dëmtimit të pompave në stacionin e pompimit nr. 102 tek ish-fabrika e makaronave të gjithë ujërat e shiut të qytetit e të kodrave përreth përmes një sistemi kanalesh vijnë tek ky stacion pompimi dhe shkojnë direkt në ITUN, duke shkaktuar ngarkesë hidraulike në ITUN e cila është menaxhuar duke hapur bypass-e dhe duke shkarkuar ujërat e zeza të pa trajtuara direkt në det. Për periudhën e audituar, paraqitet i pa garantuar funksionimi dhe qëndrueshmëria e impiantit.

**Shkaku:** Mos zbatimi i Kushteve të Veçanta të Kontratës dhe Volumit 3a, i Kërkesave të Punëdhënësit.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) Koordinatori IPA (AKUK) dhe Agjencia Implementuese/ CFCU të certifikojnë fazën operacionale të punimeve të Lotit 1 për projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” vetëm pas paraqitjes nga kontraktori të raporteve të testeve për pajisjen e përmirësuar të bllokimit të rërës dhe raportet e matjeve të sakta ditore të hyrjes dhe cilësitë dhe sasitë e flukseve dalëse të impiantit.

*Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi sipërmarrësi i punimeve “A...A” srl dhe mbikëqyrësi i punimeve “D...M” dega e shoqërisë së huaj në Shqipëri, si edhe A. T., Drejtor i njësisë IPA, përfaqësues i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në rolin e Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO) për periudhën 25.04.2017 – 17.04.2018, K. B., Koordinatori IPA (AKUM) për periudhën 11.12.2017 – 31.05.2019 dhe E. K. në rolin e Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO) Agjencia Implementuese/Drejtorja e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktive (CFCU) për periudhën 17.04.2018 – 31.05.2019, për miratimin e certifikatës së marrjes në dorëzim të punimeve të Lotit 1 për projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” në kundërshtim me nenin 12.1 të kushteve të veçanta të kontratës.*

Për sa më sipër, nga ana e z. K. B. është paraqitur observacioni si më poshtë:

**1. Komentet dhe shpjegimet e subjektit:** Referuar marrëveshjes operacionale AKUK –ja ndjek dhe këqyr të gjitha dokumentacionet e përcjella pranë saj në rrugë zyrtare. Nga ana kontraktuale e projektit, dokumentacionet, raportet, vizatimet etj. të ndjekjes së punimeve; operimit të sistemit të ndërtuar, përgatitjes dhe aprovimin e dokumentacioneve të kontraktorit “A...A” merret direkt mbikëqyrësi kontraktual. Sipas procedurave mbasi është dhënë dhe aprovimi i supervisorit këto dokumente përcillen pranë agjencisë sonë për këqyrje dhe pëlqim. Të cilat përcillen më pas SOP-së (ministrisë) për miratim zyrtarisht.

**1. Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Pas komenteve të bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit sqaron se certifikata e marrjes në dorëzim të punimeve të Lotit 1 për projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” është miratuar edhe nga Koordinatori IPA (AKUM), në kundërshtim me nenin 12.1 të kushteve të veçanta të kontratës. Për sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Ndërsa nga CFCU është paraqitur observacioni si më poshtë:



**KONTROLI I LARTË I SHËTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

**2. Komentet dhe shpjegimet e subjektit:** Në periudhën para marrjes në dorëzim të LOT 1, është kryer nga kontraktori raporti i testimit për pajisjen e përmirësuar të bllokimit të rërës, Bashkëngjitur raporti i testimit i dt. 16.02.2018 dhe 29 progres raportet mujore të supervisorit dhe kontraktorit.

**2. Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Pas verifikimit të materialit bashkëngjitur konkludojnë se në kushtet kur kërkesa për urdhrin e ndryshimit nr. 9 (përmirësimin e pajisjes së bllokimit të rërës) është bërë në datë 17.03.2018, raporti i testimit të cilit ju i referoheni nuk ka se si të jetë bërë përpara se të vendosej pajisja e përmirësuar. Ndërsa pas verifikimit të progres raporteve rezulton sërish se nuk janë raportuar të dhëna për punët gjatë fazës operationale ku përfshihen matjet e sakta ditore të hyrjes dhe cilësitë dhe sasitë e flukseve dalëse të impiantit, duke përdorur mostra cilësore 24 orëshe dhe ku të përfshihen parametrat e dhënë BOD5, Solids Suspended, Amoniak, Total Azot, Totali Fosfori nga mostra që analizohen në një laborator të certifikuar miratuar nga inxhinieri dhe analiza që merren për 7 ditë në muaj. Për sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

**d. Titulli i Gjetjes:** ITUN Vlorë që në fazat e tij fillestare është projektuar për të zhvilluar vetëm trajtimin paraprak dhe trajtimin primar të ujërave të ndotura që përfshijnë trajtimin fizik - mekanik dhe ndonëse qyteti i Vlorës paraqet një zonë sensitive mjedisore sa i përket bregdetit dhe zhvillimit të turizmit, në impiant nuk janë parashikuar të zhvillohen trajtimi sekondar qëllimi i të cilit është largimi i lëndëve organike të tretura si dhe trajtimi terciar që synon largimin e sasive të rëndësishme të azotit, fosforit, metaleve të rënda, lëndëve organike të biodegradueshme, baktereve dhe viruseve. Niveli i prurjeve në ITUN Vlorë është në nivelin 42% të mesatares së parashikuar të prurjeve, ndërsa deri në qershor 2019, 81.7% e objekteve që furnizohen me ujë janë të lidhur me rrjetin e kanalizimeve, duke mos arritur rezultatin e parashikuar që mbi 90% e popullsisë të jetë e lidhur me këtë rrjet.

**Situata:** ITUN Vlorë që në fazat e tij fillestare është projektuar për të zhvilluar vetëm trajtimin paraprak dhe trajtimin primar të ujërave të ndotura që përfshijnë trajtimin fizik- mekanik të ujit të ndotur dhe largimin e pjesshëm të lëndëve në suspensë dhe lëndëve organike me anë të metodave fizike duke reduktuar nivelet e BoD5 dhe SS të rrjedhës hyrëse me të paktën 50 % për një rrjedhë projektimi prej 160,000 PE. Në këto kushte ndonëse qyteti i Vlorës paraqet një zonë sensitive mjedisore sa i përket bregdetit dhe zhvillimit të turizmit, në impiant nuk janë parashikuar të zhvillohen trajtimi sekondar qëllimi i të cilit është largimi i lëndëve organike të tretura dhe koloidale, si dhe i lëndëve të ngurta në suspensë, që zakonisht realizohet me anë të proceseve biologjike, si dhe trajtimi terciar që synon largimin e sasive të rëndësishme të azotit, fosforit, metaleve të rënda, lëndëve organike të biodegradueshme, baktereve dhe viruseve. Referuar të dhënave të UK sh.a. Vlorë, impianti nuk prodhon sasi të konsiderueshme llumi e cila tregohet nga fakti që prurjet në impiant janë në nivelin 42% të mesatares së parashikuar të prurjeve, kjo përderisa nga përfituesi i projektit UK sh.a. Vlorë nuk janë bërë të gjithë lidhjet e rrjetit me banesat, ndonëse nga të dhënat e siguruara në UK sh.a. Vlorë rezulton se numri



**KONTROLI I LARTË I SHITIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve deri në fund të muajit qershor 2019 është 40683, ndërkohë që numri total i klientëve që furnizohen me ujë është 49778. Nga sa më sipër rezulton se 81.7% e objekteve në qytet, që furnizohen me ujë, janë të lidhur me sistemin e kanalizimit, çka tregon se për periudhën e audituar është realizuar objektivi i rritjes së përqindjes së popullsisë të lidhur me rrjetin mbledhës të kanalizimeve direkt me impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura, por nuk është arritur rezultati i parashikuar që mbi 90 % e popullsisë të jetë e lidhur me rrjetin e kanalizimeve.

**Kriteri:**

Sa më sipër është në kundërshtim me objektivat e projektit që synon në vetvete të ulë ndotjen e ujit, të përmirësojë kushtet e jetesës dhe të shëndetit për popullsinë e Bashkisë së Vlorës si edhe me rezultatin e parashikuar që mbi 90 % e popullsisë të jetë e lidhur me rrjetin e kanalizimeve.

**Ndikimi/Efekti:**

Niveli i trajtimit të ujërave të ndotura në ITUN Vlorë, duke përfshirë vetëm trajtimin primar është larg standardit të kërkuar për zonat bregdetare me përparësi zhvillimin e turizmit. 18.3 % e objekteve në qytetin e Vlorës janë ende të pa lidhura me sistemin e kanalizimeve dhe prurjet në impiant nuk përmbushin kapacitetin e parashikuar.

**Shkaku:**

Mos plotësimi i objektivave të projektit.

**Rëndësia:**

E lartë.

**Rekomandime:**

Institucionet përfituese të projektit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUK, Bashkia Vlorë dhe UK sha Vlorë të marrin masa në vazhdimësi për të kërkuar dhe programuar konform praktikave ligjore parashikimin dhe implementimin e trajtimit sekondar e terciar në ITUN Vlorë.

UK sha Vlorë të marrë masa për të rritur përqindjen e lidhjeve të popullsisë së qytetit të Vlorës me sistemin e kanalizimeve në mbi 90 %.

*Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi Zyrtaari i Lartë i Programit (SPO) Koordinatori IPA (AKUK) dhe përfituesit fundorë Bashkia Vlorë dhe UK sha Vlorë, për mosplotësim të objektivave të projektit.*

**e. Titulli i Gjetjes:**

Qeveria Shqiptare nuk ka siguruar që institucionet përfituese të projektit “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” të kenë resurse të përshtatshme financiare, materiale dhe njerëzore, në mënyrë që ndihma financiare e BE-së të përdoret në mënyrën më efektive dhe të qëndrueshme. Nga ana tjetër institucionet përfituese Zyrtaari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Koordinatori IPA (AKUM) dhe përfituesit final Bashkia Vlorë dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a. Vlorë, nuk kanë ndërmarrë masat e kërkuara për adresimin e qëndrueshmërisë së projektit, përmes përgatitjes së një plan veprimi për vitin 2019, një mekanizmi për kompetencat e përbashkëta dhe një strukture të përbashkët për koordinimin e operimit si edhe një kontrate performance ndërmjet AKUM dhe Bashkisë Vlorë, duke bërë që Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, në tetor 2018, të pezullojë pagesat për projektin e ndërtimit të sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza II, pjesë e IPA 2012.



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

**Situata:**

Për periudhën e audituar, nga Qeveria Shqiptare, nuk janë siguruar fonde në lidhje me operimin dhe mirëmbajtjen e ITUN dhe rrjetit të kanalizimeve, pasi nga të dhënat e UK sh.a. Vlorë rezulton se buxheti i këtij të fundit mund të mbulojë vetëm operacionin normal ditor të impiantit, por jo defektet apo situatat e emergjencës. Nga ana tjetër kosto e energjisë elektrike e nevojshme për të operuar impiantin është e lartë dhe e papërbalueshme nga buxheti i UK sha Vlorë. Me shkresën e datës 27.05.2019 drejtuar Zyrtarit Kombëtar Autorizues, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri shprehet se adresimi i qëndrueshmërisë së projektit bazohet në përgatitjen e një plan veprimi për vitin 2019, një mekanizmi për kompetencat e përbashkëta dhe një strukture të përbashkët për koordinimin e operimit si edhe një kontrate performance ndërmjet AKUM dhe Bashkisë Vlorë. **Për periudhën e audituar, asnjë prej strukturave të sipërcituara, kompetencë e institucioneve përfituese, nuk është ngritur, duke bërë kështu që Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri të mbajë të ndërprera pagesat për projektin e ndërtimit të sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza II, pjesë e IPA 2012.**

**Kriteri:**

Kjo është në kundërshtim me Aneksin 2 të Marrëveshjes Financiare me Komisionin Evropian në kuadër të IPA2012, (Menaxhimi i Decentralizuar) të amenduar (amendimi nr. 2 regjistruar në datë 06.08.2015).

**Ndikimi/Efekti:**

Për sa më sipër Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri ka ndërprerë pagesat për projektin e ndërtimit të sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza II, pjesë e IPA 2012, pasi në kundërshtim me Marrëveshjen Financiare 2012, **Qeveria nuk ka arritur të sigurojë qëndrueshmërinë afatgjatë të investimit duke shpërndarë resurset e nevojshme, duke përfshirë kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.** Bazuar në nenin 46(1) (a) të Rregullores së Implementimit të IPA-s, Komisioni ka ndërprerë në mënyrë formale pagesat për mangësi serioze në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të programit të cilat ndikojnë në besueshmërinë e procedurave për certifikimin e pagesave dhe për të cilat nuk janë marrë masa korrigjuese. Kjo ka shkaktuar që fondet për pagesat e faturës prej 115,725.27 € së certifikatës të ndërmjetme të punimeve nr. 16, si dhe faturën në vlerën 73,184.71 €, detyrim që lidhet me pagesën e gjysmës së parë të garancisë së punimeve mbajtur në formën e “*retention money*”, të sigurohen nga buxheti i shtetit, pasi për periudhën e audituar është paguar debia kundrejt kontraktorit të punimeve A....A S.r. në vlerën 73,184.71 € me fond të siguruar nëpërmjet procedurës *bridge financing* nga buxheti i Ministrisë së Financave, ndërkohë që pagesa e faturës prej 115,725.27 € është dakordësuar që të plotësohet në momentin më të parë të rishikimit të buxhetit 2019.

**Sa më sipër ka sjellë debitim në buxhetin e shtetit prej 73,184.71 € të cilat përbëjnë efekt negativ në buxhet, përderisa BE vazhdon të mbajë të pezulluara fondet.**

**Shkaku:**

Mos adresimi i qëndrueshmërisë së projektit nga institucionet përfituese, përmes përgatitjes së një plan veprimi për vitin 2019, një mekanizmi për kompetencat e përbashkëta dhe një strukture të përbashkët për koordinimin e



**KONTROLI I LARTË I SHTEJIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

operimit si edhe një kontrate performance ndërmjet AKUM dhe Bashkisë Vlorë.

**Rëndësia:**

E lartë.

**Rekomandime:**

Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe, Koordinatori IPA (AKUM), përfituesit final Bashkia Vlorë dhe Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Vlorë, të marrin masa menjëherë dhe në vazhdimësi për hartimin e një plan veprimi për vitin 2019, ngritjen e një mekanizmi për kompetencat e përbashkëta dhe një strukture të përbashkët për koordinimin e operimit si edhe nënshkrimin e një kontrate performance ndërmjet AKUM dhe Bashkisë Vlorë, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së projektit dhe zhbllokimin e pagesave për projektin e ndërtimit të sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza II, pjesë e IPA 2012 dhe eliminimin e efektit negativ prej 73,184.71 €.

*Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohen me përgjegjësi institucionet përfituese të projektit, Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë A. T., për periudhën 25.04.2017 – 17.04.2018, Koordinatori IPA (AKUM) K. B., për periudhën 11.12.2017 – 31.05.2019, përfituesit final Bashkia Vlorë dhe Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Vlorë për mos adresimin e qëndrueshmërisë së projektit.*

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 4 datë 31.07.2019 dhe për këtë çështje nga ana e z. K. B. është paraqitur observacioni si më poshtë:

**1. Komentet dhe shpjegimet e subjektit:** Me përgatitjen e Planit të Veprimit për vitin 2019 është marrë direkt ish-Drejtori i Përgjithshëm dhe koordinatori aktual në detyrë.

**1. Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Pas komenteve të bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit sqaron se z. K. B. ka qenë Koordinatori IPA (AKUM), për periudhën 11.12.2017 – 31.05.2019, periudhë e cila përfshin kohën në të cilën nga BE është kërkuar realizimi i planit të veprimit për vitin 2019 nga institucionet përfituese. Për më tepër adresimi i qëndrueshmërisë së projektit është një detyrim i institucioneve përfituese parashikuar në Aneksin 2 të Marrëveshjes Financiare me Komisionin Evropian në kuadër të IPA2012, (Menaxhimi i Decentralizuar) të amenduar (amendimi nr. 2 regjistruar në datë 06.08.2015). Për sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

**f. Titulli i Gjetjes:** Institucioni përfitues i të projektit “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II”, Koordinatori IPA pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve, ka refuzuar fondin prej 3.4 milion € të ofruar nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri për të siguruar qëndrueshmërinë e ITUN Vlorë përmes mos pranimit të përfshirjes së stacionit të pompimit nr. 102 (ish fabrika e makaronave) në sistemin SCADA me qëllim monitorimin dhe sigurimin funksionimit e impiantit. Kjo ka shkaktuar mos zgjidhjen e problematikës të shkaktuar nga flukset e pakontrolluara hidraulike dhe mos garantimin e qëndrueshmërisë së projektit.

**Situata:**

Gjatë fazës operacionale të funksionimit të ITUN Vlorë është konstatuar se sasia e ujit që vjen në impiant është mbi kapacitetin maksimal të parashikuar në



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

projekt, kjo për shkak të dëmtimit të pompave në stacionin e pompimit nr. 102 tek ish-fabrika e makaronave, e cila ka bërë që të gjithë ujërat e shiut të qytetit e të kodrave përreth përmes një sistemi kanalesh vijnë tek ky stacion pompimi dhe shkojnë direkt në ITUN, duke shkaktuar ngarkesë hidraulike në impiant. Kjo ngarkesë është menaxhuar duke hapur bypass-e dhe duke shkarkuar ujërat e zeza të patrajuara direkt në det. Në kuadër të problematikës së sipërcituar në datë 15.06.2018, nga mbikëqyrësi i punimeve është kërkuar urdhri i ndryshimit nr. 10, i cili konsiston në punimet për përfshirjen e stacionit të pompimit nr. 102 (ish fabrika e makaronave) në sistemin SCADA me qëllim monitorimin dhe sigurimin funksionimit të ITUN, duke eliminuar kështu problematikën e shkaktuar nga flukset e pakontrolluara hidraulike. Për sa më sipër autoriteti kontraktor CFCU ka përcaktuar se kjo kërkesë përbën amendim kontrate dhe jo urdhër ndryshimi dhe ka kërkuar opinionin teknik të institucioneve përfituese Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Për çështjen e mësipërme Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri në minutat e takimit të mbledhjes së datës 13.08.2018 është shprehur i hapur për të përdorur 3.4 milion €, si kursime nga prokurimi i kontratës fillestare, nëse punimet për të cilat do të shkojë ky fond, lidhen me qëndrueshmërinë e projektit dhe arrijnë të përfundojnë para datës finale të operimit dhe implementimit. Në e-mail-in e datës 05.07.2018, K. B., Koordinator i Projekteve IPA pranë AKUK është shprehur se ndonëse problematika qëndron, ajo është e njohur jo vetëm për këtë stacionin nr. 102, por për të gjithë stacionet e pompimit të qytetit të Vlorës dhe për këtë duhet të trajtohet në një studim të detajuar në një projekt të veçantë duke përfshirë si më të rëndësishëm për përfituesin ristrukturimin e gjithë sistemit të vjetër KUZ përmes një projekti të ri të mirë detajuar ku të përfshihet edhe rikonstruksioni i Stacionit të Pompimit nr. 102. Për menaxhimin e situatave të jashtëzakonshme të prurjeve hidraulike në ITUN, AKUK ka sugjeruar që ato të trajtohen me përdorimin e by-passit të ndërtuar për këtë qëllim sipas Urdhrit të Ndryshimit nr. 7 (VO7), pra duke shkarkuar ujërat e ndotura të patrajuara direkt në det. Sa më sipër, nuk është realizuar një amendim i kontratës për sigurimin e funksionimit të ITUN nëpërmjet përfshirjes së stacionit të pompimit nr. 102 në sistemin SCADA.

**Kriteri:**

Kjo është në kundërshtim me Aneksin 2 të Marrëveshjes Financiare me Komisionin Evropian në kuadër të IPA2012, (Menaxhimi i Decentralizuar) të amenduar (amendimi nr. 2 regjistruar në datë 06.08.2015), me VKM nr. 23, datë 12.01.2011 *“Për Përcaktimin e Funksioneve, Përgjegjësi dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Autoriteteve të Strukturave të Menaxhimit të Decentralizuar të Asistencës së Bashkimit Evropian në Kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), Komponenti I: Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional”* i ndryshuar si dhe me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar, neni 248.

**Ndikimi/Efekti:** **Sa më sipër ka sjellë refuzimin (djegien) e fondeve grant nga BE ne masën 3.4 mil € duke shkaktuar efekt negativ në përfitimin dhe përdorimin e fondeve publike.** Nëpërmjet këtij veprimi gjithashtu nuk është siguruar



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

qëndrueshmëria e projektit, si edhe mos përfshirja e stacionit të pompimit nr. 102 te (ish fabrika e makaronave) në sistemin SCADA ka ndikuar në mos zgjidhjen e problematikës së shkaktuar nga flukset e pakontrolluara hidraulike dhe duke mos garantuar funksionimin e ITUN Vlorë.

**Shkaku:**

Shkak për këtë ka qenë refuzimi i z. K. B. në funksionin e Koordinatorit IPA në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve, në rolin e institucionit përfitues për të marrë e përdorur fondin prej 3.4 milion € të ofruar nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri për adresimin e qëndrueshmërisë.

**Rëndësia:**

E lartë.

**Rekomandime:**

Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) dhe Koordinatori IPA, të marrë masa në vazhdimësi, për zbatimin e Marrëveshjes Financiare me Komisionin Evropian në kuadër të IPA2012, (Menaxhimi i Decentralizuar) dhe kompetencave që i atribuon VKM nr. 23, datë 12.01.2011 duke përdorur të gjithë fondet e ofruara nga BE me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së projekteve përmes asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë dhe mbështetjes për kryerjen e reformave në përputhje me të drejtën Komunitare, me synimin përgatitjen plotësisht për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit për në Bashkimin Evropian.

*Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. K. B. në funksionin e Koordinatorit IPA (AKUM), si institucion përfitues i projektit, për kryerjen e veprimeve që kanë dëmtoar interesat e ligjshëm të shtetit duke refuzuar fondin prej 3.4 milion € të ofruar nga BE për adresimin e qëndrueshmërisë së projektit.*

Për sa më sipër, nga ana e z. K. B. është paraqitur observacioni si më poshtë:

**1. Komentet dhe shpjegimet e subjektit:** Funksioni që kam ushtruar nuk ka autoritet pranues apo autorizues për çështjen në fjalë. Referuar korrespondencës është kërkuar dhe është dhënë një mendim teknik. Në këtë mendim teknik kërkohet zgjerimi i këtij projekti jo vetëm në një nënstacion, po për të gjithë Vlorën, duke theksuar kështu qëndrueshmërinë në nivel qyteti dhe jo një stacioni të izoluar. Në dijeninë time, referuar Stacionit të pompimit 102, të përmendur që është jashtë termave kontraktuale të projektit u kërkuar nga supervizori me propozim të kontraktit rinovimi i i tij me anë të një urdhër ndryshimi. Mbas këqyrjes së dokumentacioneve referuese dhe inspektimit në vend me të gjithë përfaqësuesit dhe projektuesin e këtij stacioni, u konstatua nga ana jonë se shumë gjëra të paraqitura nga supervizori nuk qëndronin. Pompat e stacionit punonin në gjendje aktive pavarësisht amortizimit në vite. Vënia në funksion bëhej nga ndërmarrja e UK Vlorë sipas urdhrave të drejtuesve dhe jo sipas regjimit të funksionimit të stacionit. Mirëmbajtja të linte për të dëshiruar dhe ruajtja dhe operimi ishte me personel të pakualifikuar. Si rrjedhojë e konsultimeve me eprorin tim direkt ish Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë u kthye një përgjigje me email kërkesës së Autoritetit kontraktues znj. K., për mendim teknik sipas shkresave bashkëngjitur.

**1. Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Pas komenteve të bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit sqaron se referuar kërkesës së dërguar z. B., në rolin e Koordinatorit IPA (AKUM) nga Drejtori i Përgjithshëm i CFCU znj. E. K. në 29.06.2018, përcaktohet sakë se



**KONTROLLI I LARTË I SHITIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BESË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

bazuar në nenin 13 të kushteve të veçanta të kontratës së punimeve, punimet shtesë për rehabilitimin e SP 102 do të çojnë në amendim të kontratës **me ndryshime teknike** dhe me impakt financiar. Për këtë bazuar në Aneksin 2 të Marrëveshjes Financiare me Komisionin Evropian në kuadër të IPA2012, (Menaxhimi i Decentralizuar) të amenduar (amendimi nr. 2 regjistruar në datë 06.08.2015), me VKM nr. 23, datë 12.01.2011, si edhe referuar Marrëveshjes Operacionale për projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II”, ku përcaktohet se: AKUM është enti përfitues nga kontrata dhe njësia IPA brenda saj është përgjegjëse për implementimin teknik të Projektit, qëndrimi teknik nga ana juaj ka qenë përcaktues në implementimin ose jo të këtyre ndryshimeve teknike dhe rrjedhimisht përfitimit të fondit shtesë. Për këtë keni qenë në dijeni edhe nëpërmjet kërkesës në paragrafin e katërt të së cilës shprehet qartë se në rastin e mbështetjes së këtij propozimi nga përfituesi AKUM, do të vazhdohet me procedurën dhe llogaritjen e afateve të implementimit. Sa i përket pretendimit se lidhur me SP 102 *shumë gjëra të paraqitura nga supervizori nuk qëndronin*, nuk është paraqitur asnjë dokument bashkëngjitur ku të vërtetohet inspektimi i gjendjes në vend nga ana juaj.

**Si përfundim ndërhyrja në këtë stacion pompimi nuk pengon zgjerimin e projektit për të gjithë Vlorën në një fazë tjetër apo në një projekt tjetër, ndaj ky fakt nuk përbën shkak për refuzimin e këtij ndryshimi teknik dhe financiar të kontratës së punimeve nga ana juaj, me rezultat mos përfitimin e grantit prej 3.4 milion € ofruar nga BE.**

Për sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Projekti i zbatimit “Ndërtimit i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II”: nuk ka realizuar objektivat e kontratës së nënshkruar: Përmirësimi i mjedisit, kushteve të jetesës dhe shëndetit të popullsisë në Vlorë në përputhje me Standardet Evropiane në lidhje me cilësinë e ujit dhe menaxhimin e humbjeve, rehabilitimin dhe zgjerimin e impiantit ekzistues për trajtimin e ujërave të ndotura në Bashkinë Vlorë. Kanalizimet e qytetit të Vlorë nuk janë funksionale në masën e projektuar, 90 % e popullatës së qytetit nuk ka pasur deri në vitin 2017 (e nuk ka deri sot) qasje në kanalizimet publike. Zbatimi i projektit të sipërcituar ka përfunduar pa u realizuar faza e fundit e sistemit të përpunimit të ujërave të ndotura. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me kontratën me nr. AL/IPA2012/04 e hyrë në fuqi me datë 09.12.2015 dhe elementet kyç të programit, objektivat, zgjedhjen e projektit, lidhjen me strategjitë kombëtare dhe koordinimi me asistencën e donatorëve, sinergjinë midis strukturave të përcaktuara për projektimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programimit të IPA-s 2012 “Ndërtimit i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 29 – 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Institucionet e ngarkuara për programimin dhe zbatimin e fondeve IPA; CFCU në rolin e Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO), Zyrtarit i Lartë të Programit (SPO), AKUM në rolin e Përfituesit, Koordinatori Kombëtar i Instrumentit të Para zgjerimit (NIPAC) dhe UKV të bëjnë më shumë përpjekje për mbikëqyrjen e procesit nga faza e programimit dhe përgatitjes buxhetore, në fazat e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit nëpërmjet realizueshmërisë



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

së objektivave të Projektit. Është e domosdoshme që të përmirësohen kapacitetet e strukturave përgjegjëse dhe koordinimi më i mirë midis institucionet për zbatimin Koordinim më i mirë midis këtyre institucioneve.

*Në vazhdimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Qeveria Shqiptare nuk ka siguruar që institucionet përfituese të projektit “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” të kenë resurse të mjaftueshme financiare, materiale dhe njerëzore, në mënyrë që ndihma financiare e BE-së të përdoret në mënyrën më efektive dhe të qëndrueshme. Nga ana tjetër institucionet përfituese Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Koordinatori IPA pranë AKUM dhe përfituesit final Bashkia Vlorë dhe Ujësjetllës Kanalizime SHA. Vlorë, nuk kanë ndërmarrë masat e kërkuara për adresimin e qëndrueshmërisë së projektit, përmes përgatitjes së një plan veprimi për vitin 2019, një mekanizmi për kompetencat e përbashkëta dhe një strukturë të përbashkët për koordinimin e operimit si edhe një kontratë performance ndërmjet AKUM dhe Bashkisë Vlorë, duke bërë që Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, të pezullojë pagesat për projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza II”, pjesë e IPA 2012. Kjo është në kundërshtim me Aneksin 2 të Marrëveshjes Financiare me Komisionin Evropian në kuadër të IPA2012, (Menaxhimi i Decentralizuar) të amenduar (amendimi nr. 2 regjistruar në datë 06.08.2015). Për sa më sipër Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, në tetor 2018, ka ndërprerë pagesat për projektin e ndërtimit të sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza II, pjesë e IPA 2012, pasi në kundërshtim me Marrëveshjen Financiare 2012. Institucionet përfituese të projektit, Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe, Koordinatori IPA (AKUM), përfituesit final Bashkia Vlorë dhe Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Vlorë nuk kanë arritur të sigurojë qëndrueshmërinë afatgjatë të investimit duke shpërndarë resurset e nevojshme, duke përfshirë kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes. Bazuar në nenin 46(1)(a) të Rregullores së Implementimit të IPA-s, Komisioni ka ndërprerë në mënyrë formale pagesat për mangësitë në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të programit të cilat ndikojnë në besueshmërinë e procedurave për certifikimin e pagesave dhe për të cilat nuk janë marrë masa korrigjuese. Pasi institucionet përfituese kanë dështuar në realizimin e kërkesave të delegacionit për hartimin e një plani veprimi, ngritjen e mekanizmave të kompetenca të përbashkëta dhe koordinuese të projektit, mungesës së kontratës së performancës së vitit 2019 si dhe mungesës së një marrëveshje operimi midis Bashkisë Vlorë dhe AKUM. Kjo ka shkaktuar që fondet për pagesat e faturës prej 115,725.27 € së certifikatës të ndërmjetme të punimeve nr. 16 si dhe faturën në vlerën 73,184.71 €, detyrim që lidhet me pagesën e gjysmës së parë të garancisë së punimeve mbajtur në formën e “Retention Money”, të sigurohen nga buxheti i shtetit, pasi për periudhën e audituar është paguar debia kundrejt kontraktorit të punimeve “A....A” S.r.l Degë e Shoqërisë së Huaj në vlerën 73,184.71 € me fond të siguruar nëpërmjet procedurës ‘bridge financing’ nga buxheti i Ministrisë së Financave, ndërkohë që pagesa e faturës prej 115,725.27 € është dakordësuar që të plotësohet në momentin më të parë të rishikimit të buxhetit 2019. Sa më sipër ka sjellë debitim të buxhetit të shtetit prej 73,184.71 € të cilat përbëjnë zballancim burimesh financimi si pasojë e mungesës së aftësive thithëse të donacioneve, për sa kohë BE vazhdon të mbajë të pezulluara fondet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 40 – 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Koordinatori IPA pranë AKUM, përfituesit final Bashkia Vlorë dhe Ujësjetllës



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

Kanalizime SHA. Vlorë, të marrin masa për hartimin e një plan – veprimi për vitin 2019, ngritjen e një mekanizmi për kompetencat e përbashkëta dhe një strukturë të përbashkët për koordinimin e operimit si edhe nënshkrimin e një kontrate performance ndërmjet AKUM dhe Bashkisë Vlorë, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së projektit, zhbllokimin e pagesave për Projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza II”, pjesë e IPA 2012 dhe eliminimin e efektit negativ prej 73,184.71 €.

***Menjëherë***

**3. Gjetje nga auditimi:** Gjatë fazës operacionale të funksionimit të ITUN Vlorë është konstatuar se sasia e ujit që vjen në impiant është mbi kapacitetin maksimal të parashikuar në projekt, kjo për shkak të dëmtimit të pompave në stacionin e pompimit nr. 102 tek ish-fabrika e makaronave, e cila ka bërë që të gjithë ujërat e shiut të qytetit e të kodrave përreth përmes një sistemi kanalesh vijnë tek ky stacion pompimi dhe shkojnë direkt në ITUN, duke shkaktuar ngarkesë hidraulike në impiant. Në kuadër të zgjidhjes së problematikës së sipërcituar, Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri është shprehur i hapur për të përdorur 3.4 milion €, si kursime nga prokurimi i kontratës fillestare, nëse punimet për të cilat do të shkojë ky fond, lidhen me qëndrueshmërinë e projektit dhe arrijnë të përfundojnë para datës finale të operimit dhe implementimit.

Institucioni përfitues i projektit “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II”, Koordinatori IPA, K. B., pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve, ndonëse ka pranuar problematikën e ngritur, ka refuzuar fondin prej 3.4 milion € të ofruar nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri duke ndikuar negativisht në qëndrueshmërinë e projektit, si edhe në zgjidhjen e problematikës së shkaktuar nga flukset e pakontrolluara hidraulike duke mos garantuar funksionimin e ITUN Vlorë. Veprim ky në kundërshtim me Aneksin 2 të Marrëveshjes Financiare me Komisionin Evropian në kuadër të IPA2012, (Menaxhimi i Decentralizuar) të amenduar (amendimi nr. 2 regjistruar në datë 06.08.2015) si dhe me VKM nr. 23, datë 12.01.2011 “Për Përcaktimin e Funksioneve, Përgjegjësisë dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Autoriteteve të Strukturave të Menaxhimit të Decentralizuar të Asistencës së Bashkimit Evropian në Kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), Komponenti I: Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional” të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 42 – 45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) dhe Koordinatori IPA, të marrë masa për zbatimin e Marrëveshjes Financiare me Komisionin Evropian në kuadër të IPA2012, (Menaxhimi i Decentralizuar) dhe kompetencave që i atribuon VKM nr. 23, datë 12.01.2011 duke përdorur të gjithë fondet e ofruara nga BE me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së projekteve përmes asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë dhe mbështetjes për kryerjen e reformave në përputhje me të drejtën Komunitare, me synimin përgatitjen plotësisht për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit për në Bashkimin Evropian.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**4. Gjetje nga auditimi:** Projekti i zbatimit të punimeve: “Ndërtimit i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” Lotin 1: (varianti 2 dhe 4), janë projekte që nuk plotësojnë kushtin që financimi në ITUN të jetë përfundimtar për funksionimin e impiantit. Variantet e përzgjedhura nuk kanë marrë në konsideratë ndikimin në mjedis sipas legjislacionit shqiptar dhe Standardeve Evropiane si dhe kushtet e kontratës. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenet 5, 6 dhe



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

7 të Ligjit nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Kreun III, Kreun IV e Kreun V të VKM nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”, Standardet Evropiane dhe pikën 2.4 “Çështjet ndërsektoriale” të aneksit A, “Programi kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e komponentit IPA për asistencën dhe forcimin institucional për vitin 2012” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 30 – 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Autoritetet e menaxhimit të projekteve në bashkëpunim me institucionet përfituese, duhet të përgatisin në sinergji prioritetet, studimet e fizibilitetit, projektet dhe implementimin e punimeve të miratuara sipas marrëveshjeve të financimit, sipas legjislacionit shqiptar dhe Standardeve Evropiane si dhe kushteve të kontratës. Planifikimi të përfshijë veprimet/masat, afatin final, buxhetin e vlerësuar, institucionin përgjegjës për buxhetin, institucion përgjegjës për veprimet implementuese, institucionin përgjegjës për koordinimin e veprimeve.

*Në vazhdimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** ITUN Vlorë, pjesë e projektit “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” që në fazat e tij fillestare është projektuar për të zhvilluar vetëm trajtimin paraprak dhe trajtimin primar të ujërave të ndotura që përfshijnë trajtimin fizik- mekanik. Ndonëse qyteti i Vlorës paraqet një zonë sensitive mjedisore sa i përket bregdetit dhe zhvillimit të turizmit, në impiant nuk janë parashikuar të zhvillohen trajtimi sekondar si dhe trajtimi terciar. Qëllimi i këtyre trajtimeve është largimi i lëndëve organike të tretura dhe largimi i sasive të rëndësishme të azotit, fosforit, metaleve të rënda, lëndëve organike të biodegradueshme, baktereve dhe viruseve.

Niveli i prurjeve në ITUN Vlorë është në nivelin 42 % të mesatares së parashikuar të prurjeve, ndërsa deri në qershor 2019, 81.7 % e objekteve që furnizohen me ujë janë të lidhur me rrjetin e kanalizimeve, duke mos arritur rezultatin e parashikuar që mbi 90 % e popullsisë të jetë e lidhur me këtë rrjet. Sa më sipër është në kundërshtim me objektivat e projektit që synon në vetvete të ulë ndotjen e ujit, të përmirësojë kushtet e jetesës dhe të shëndetit për popullsinë e Bashkisë së Vlorës si edhe me rezultatin e parashikuar që mbi 90% e popullsisë të jetë e lidhur me rrjetin e kanalizimeve. Niveli i trajtimit të ujërave të ndotura në ITUN Vlorë, duke përfshirë vetëm trajtimin primar është larg standardit të kërkuar për zonat bregdetare me përparësi zhvillimin e turizmit. Prurjet në impiant nuk përmbushin kapacitetin e parashikuar pasi 18.3 % e objekte në qytetin e Vlorës janë ende të pa lidhura me sistemin e kanalizimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 39 – 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Institucionet përfituese të projektit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUK, Bashkia Vlorë dhe UK SHA Vlorë të marrin masa në vazhdimësi për të kërkuar dhe programuar konform praktikave ligjore parashikimin dhe implementimin e trajtimit sekondar e terciar në ITUN Vlorë.

*Në vazhdimësi*

**5.2 Rekomandimi:** UK SHA Vlorë të marrë masa për të rritur përqindjen e lidhjeve të popullsisë së qytetit të Vlorës me sistemin e kanalizimeve në mbi 90 %.

*Në vazhdimësi*



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

**6. Gjetje nga auditimi:** Komunikimet me përfituesin final të projektit “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II, Ujësjellës Kanalizime SHA Vlorë janë zhvilluar vetëm në fazën operacionale të projektit, pra kur ka përfunduar ndërtimi i Impiantit të Trajtit të Ujërave të Ndotur (ITUN) Vlorë. Kjo ka sjellë si pasojë që ITUN Vlorë të mos projektohet, llogaritet e zbatohet për një rrjet të kombinuar të ujërave të bardha me atë të ujërave të zeza, siç edhe është faktikisht rrjeti i kanalizimeve të qytetit të Vlorës dhe ka bërë njëkohësisht që investimi të paraqesë probleme gjatë fazës së operimit siç rezultuan p.sh:

- Dy kompresorët me defekt në pritje të kontraktuesit për ti riparuar;
- Pompa M002 ende e pa lidhur nga kontraktuesi;
- Nga stacioni i pompimit PS-AX1 nuk vijnë të dhëna, vetëm sinjali i kamerave;
- Një pjesë e ndriçimit të jashtëm vazhdon të jetë ende jashtë funksionit;
- Etj.;

Gjithashtu, u konstatua se sasia e ujit që vjen në impiant është mbi kapacitetin maksimal të parashikuar në projekt, duke shkaktuar si ngarkesë hidraulike ashtu edhe hyrjen e rërës në të. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 2.6 ii) të Projekt Fishës së amendamentit nr. 2 të marrëveshjes së financimit ku përcaktohet se: Në të kaluarën, disa autoritete lokale nuk pranuan të merrnin pronësinë e investimeve. Për këtë arsye të gjithë përfituesit (Ujësjellës Kanalizime Vlorë dhe Bashkia e Vlorës) **duhet të përfshihen** nga faza e hershme e përgatitjes së studimeve të fizibilitetit dhe përgatitjes së projekteve dhe gjithashtu gjatë zbatimit. Si edhe në kundërshtim me VKM nr. 23, datë 12.01.2011 “Për Përcaktimin e Funksioneve, Përgjegjësive dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Autoriteteve të Strukturave të Menaxhimit të Decentralizuar të Asistencës së Bashkimit Evropian në Kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), Komponenti I: Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional” të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 33 – 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU) dhe Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për projektet e decentralizuara në kuadër të IPA 2012 të marrë masa për përfshirjen e të gjithë përfituesve, edhe atyre fundorë, që nga faza e hershme e përgatitjes së studimeve të fizibilitetit dhe përgatitjes së projekteve dhe gjithashtu gjatë zbatimit.

*Në vazhdimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe verifikimi i situatës faktike të ITUN rezultoi se nuk është siguruar kapaciteti absorbues i autoriteteve të menaxhimit të Instrumentit të Para zgjerimit, rritja e kapaciteteve institucionale, forcimi i strukturave, sistemeve dhe burimeve njerëzore. Trajnimet e kryera për punonjësit e ITUN janë minimale. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim Rezultatit 1 të Aneksit 1 dhe Pikën 2.5 e Aneksit 2 të Programit Kombëtar për Shqipërinë nën ndihmën tranzitore IPA dhe komponenti i ndërtimit institucional për 2012 (menaxhimi i decentralizuar). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 31 – 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Institucionet e ngarkuara për programimin dhe zbatimin e fondeve IPA të sigurojnë asistencë të vazhdueshme për implementimin e programeve paraaderuese në mënyrë që të garantojë se:

- Koordinimi mes Ministrive të linjës dhe institucioneve lokale është i përshtatshëm mes mekanizmave ndër-institucional për programimin dhe implementimin e IPA duke alokuar burimet e nevojshme që përfshijnë kosto të funksionimit dhe të mirëmbajtjes;



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

- Qëndrueshmërinë afatgjatë të investimit;
- Nëpunësit civil të trajnuar për menaxhimin e fondeve IPA të qëndrojnë në funksionet e tyre, pavarësisht ndryshimeve të nivelit drejtues;
- Institucionet përfituese të kenë burimet e duhura njerëzore, financiare dhe materiale në mënyrë që mbështetja financiare evropiane të mund të përdoret me sa më shumë efikasitet;
- Institucionet përfituese do të organizojnë, përzgjedhin dhe të caktojnë anëtarë të grupeve të punës, të drejtojnë, monitorojnë dhe koordinojnë komitete dhe seminare siç kërkohet nga aktivitetet të projektit.

*Në vazhdimësi*

**7.2 Rekomandimi:** Të merren masa nga CFCU (PAO), Zyrtari Kombëtar Autorizues (NAO), Zyrtari Përgjegjës Akreditues (CAO) dhe Koordinator i Instrumentit të Parazgjerimit (NIPAC) për përfshirjen në strukturat e Drejtorisë së CFCU të punonjësve me profile të përshtatshme për kryerjen e detyrave funksionale ashtu siç përshkruhet në dokumentin Manuali i Procedurave të Brendshme – CFCU, Aneksi D *Përshkrimi i Punës* me qëllim sigurimin e një stafi të kualifikuar si dhe me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të përgjithshme dhe objektivat e Drejtorisë.

*Në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga krahasimi i datave të miratimit të urdhrit të ndryshimit (VO) nr. 9 dhe asaj të dorëzimit të certifikatës së marrjes në dorëzim të punimeve të Lotit 1 për projektin *Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II*, rezulton se punimet e parashikuara për përmirësimin e pajisjes së bllokimit të rërës të përfshira në urdhrin ndryshimit nr. 9, në fakt janë realizuar përpara se ky urdhër të miratohej. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” dhe Udhëzim nr. 2, datë 13.5.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”. Për sa më sipër, sipërmarrësi “A...A” s.r.l dhe mbikëqyrësi i punimeve “D...M” dega e shoqërisë së huaj në Shqipëri kanë ndryshuar projektin, kanë realizuar punime dhe kanë kërkuar certifikimin e tyre, në kushtet që këto punime nuk kanë qenë të miratuara nga Autoriteti Kontraktor. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 35 – 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1 Rekomandimi:** Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) Koordinator i IPA (AKUK) dhe Agjencia Implementuese/Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktive (CFCU), të marrë masa për të lejuar zbatimin e ndryshimeve në projektet e decentralizuara në kuadër të IPA 2012, vetëm pas miratimeve paraprake nga autoritetet e mësipërme.

*Në vazhdimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Kontraktori i punimeve të Lotit 1 për projektin “*Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II*”, “A...A” s.r.l, nuk ka dokumentuar apo paraqitur në Raportin e Testimeve asnjë test të lidhje me funksionimin e pajisjes së përmirësuar të bllokimit të rërës. Kontraktori gjithashtu nuk ka përmbushur detyrimin e përgatitjes dhe dorëzimit të një raporti mujor për punët gjatë fazës operationale ku përfshihen matjet e sakta ditore të hyrjes dhe cilësitë si dhe sasitë e flukseve dalëse të impiantit. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 12.1 të Kushteve të Veçanta të Kontratës si edhe me Kërkesat e Punëdhënësit të Volumit 3a, pika 6 e kontratës së punimeve Europe/136785/DH/SER/AL. Në këto kushte efektiviteti i përmirësimit të pajisjes së bllokimit të rërës është i pa provuar dhe duke patur prezent edhe faktin që rrjeti i



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

ujërave të bardha në Vlorë është i kombinuar me atë të ujërave të zeza dhe që sasia e ujit që vjen në ITUN është mbi kapacitetin maksimal të parashikuar në projekt, ku për shkak të dëmtimit të pompave në stacionin e pompimit nr. 102 (tek ish-fabrika e makaronave) të gjithë ujërat e shiut të qytetit e të kodrave përreth përmes një sistemi kanalesh vijnë tek ky stacion pompimi dhe shkojnë direkt në ITUN, duke shkaktuar ngarkesë hidraulike në ITUN e cila është menaxhuar duke hapur bypass-e dhe duke shkarkuar ujërat e zeza të patrajtuara direkt në det; për periudhën e audituar, paraqitet i pa garantuar funksionimi dhe qëndrueshmëria e impiantit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 37 – 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) Koordinatori IPA (AKUK) dhe Agjencia Implementuese/Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktive (CFCU) të certifikojnë fazën operacionale të punimeve të Lotit 1 për projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” vetëm pas paraqitjes nga kontraktori të raporteve të testimeve për pajisjen e përmirësuar të bllokimit të rërës dhe raportet e matjeve të sakta ditore të hyrjes dhe cilësitë dhe sasi të e flukseve dalëse të impiantit.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit teknik të dosjes së zbatimit për kontratën e punimeve me objekt “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë , Faza II” të lidhur sipas aktit me nr. AL/IPA2012/04 datë 09.12.2015 mes z. M. S. ish – Drejtor i Përgjithshëm në CFCU, në rolin e punëdhënësit, z. S. F. Administrator i “A...A” S.r.l, Itali, në rolin e përfaqësuesit të BOE, u konstatua se janë negociuar si më poshtë:

- d) *Punime të montimit me çmime dhe me strukturë kostoje njëloj si punime ndërtimi;*
- e) *Zëra të rinj me normativa mbi ato të manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi në kohën e realizimit të punimeve;*
- f) *Zëra të rinj jashtë manualit me një fitim prej 10 %, kur në fakt në kontratë është parashikuar një fitim prej 5 % mbi kostot;*

Si rrjedhojë e këtyre analizave të gabuara rezultojnë se janë përdorur pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet shuma **156,557 €**. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me:

- Kontratën e shërbimit me objekt “Supervizimi i ndërtimit të rrjetit të kanalizimit në Vlorë, faza II” lidhur sipas asaj me nr. EuropeAid/136786/DH/SER/AL me numër identifikimi AL/IPA2012/04 e cila ka hyrë në fuqi me datë 03.12.2015, konkretisht artikulli 7 *Obligimet e Kontraktorit* tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës Aneksi I;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Punimeve me nr. AL/IPA2012/05 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Pika 13.3 *Procedurat e Ndryshimeve*, paragrafi i fundit
- Kushteve të Veçanta të Kontratës:
- pika 1.2 *Interpretime* në të cilin këtij paragrafi i është shtuar një formulim
- pika 1.4 *Ligji dhe Gjuha*;
- pika 12.7 *Vlerësimi* paragrafi i fundit;



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III,
  - VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;
  - Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”
  - Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I, germa A, paragrafi i fundit
  - Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II,
  - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3
  - VKM nr. 23 datë 12.01.2011 “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), Komponenti I : Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional”, Pikat 8, 9 dhe Pika 11, germa b, paragrafi i;
  - Marrëveshjet Operacionale, përkatësisht të hyra në fuqi në datë 06.08.2015, 28.06.2016 dhe në datë 05.02.2018:
    - ❖ Artikulli 6 Përgjegjësitë e Zyrtarit të Lartë të Programit, nënartikujt Implementimi dhe Monitorimi, paragrafi i parë pas paragrafit me germën i të këtij Artikulli,
    - ❖ Artikulli 4 Përgjegjësitë e Zyrtarit Autorizues të Programit, në veçanti nënartikulli e) Pagesat, paragrafi i parë dhe i tretë
    - ❖ Artikulli 16 ‘Pagesat’, pika 2;
  - Artikulli 17 ‘Parregullsitë dhe rikuperimi i shumave të paguara gabimisht’ Marrëveshjen Operacionale për projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II”, të lidhur në qershor 2016 mes Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Financimit dhe Kontraktimit të Fondeve të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë, në rolin e Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO) në cilësinë e ‘punëdhënësit’, përfaqësuesit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO) si dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime, në cilësinë e ‘përfituesit’, konkretisht Artikulli 1, , Artikulli 3, 4 dhe Artikulli 5.
  - Manualin e Brendshëm të Procedurave të CFCU, konkretisht:
    - Seksioni C Menaxhimi dhe Organizimi, Kapitulli 3.4 Detyrat e CFCU, nënkaptulli 3.4.6 Pagesat e Kontratave;
    - Seksioni D Burimet Njerëzore, Aneksi 1 Përshkrimi i punës, PAO Drejtuesi i CFCU;
    - Seksioni D Burimet Njerëzore, Aneksi 1 Përshkrimi i punës, Specialist Kontrate;
- (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 17 – 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga CFCU në rolin e Zyrtarit Autorizues të Programit (PAO), Zyrtarit i Lartë të Programit (SPO), Përfituesi dhe Koordinatori Kombëtar i Instrumentit të Parazgjerimit (NIPAC) që në vazhdimësi, të sigurohet një zbatim korrekt dhe me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet i kontratave me fonde nga BE, Bankës Botërore dhe donatorëve të tjerë me qëllim maksimizimin e përfitimit nga Shteti Shqiptar prej këtyre fondeve.

*Në vijimësi*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-**  
**SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA**  
**2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

## **V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT**

Ne kemi përfunduar auditimin e veprimtarisë ekonomiko financiare në CFCU për Projektin “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” për periudhën nga fillimi deri në 31.05.2019.

### **Baza për opinionin e kualifikuar.**

Auditimi në subjektin CFCU për Projektin “Ndërtimi i Sistemit të Kanalizimit në Vlorë, Faza II” është kryer në përputhje me Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000<sup>1</sup> dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, në zbatim kjo të ISSAI 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.2008. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Kampioni i procedurave dhe transaksioneve është ndërtuar mbi bazën e vlerësimit të nivelit të materialitetit dhe risqeve të devijimeve nga kriteret dhe kuadri ligjor. Nga auditimi u konstatuan devijime nga baza ligjore dhe rregullatore në fuqi, përfshirë rregullat e marrëveshjeve të financimit, ligjshmërisë së ndërtimit dhe ato kontraktore. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës tonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar të auditimit të përputhshmërisë**. Projekti i ndërtimit të sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II, që në hartim të tij ka parashikuar që Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) Vlorë të zhvillojë vetëm trajtimin paraprak dhe trajtimin primar të ujërave të ndotura që përfshijnë trajtimin fizik-mekanik. Ndonëse qyteti i Vlorës paraqet një zonë sensitive mjedisore sa i përket bregdetit dhe zhvillimit të turizmit, në impiant nuk janë parashikuar të zhvillohen trajtimi sekondar si dhe trajtimi terciar. Këto trajtime realizojnë largimin e lëndëve organike të tretura si dhe largimin e sasive të rëndësishme të azotit, fosforit, metaleve të rënda, lëndëve organike të biodegradueshme, baktereve dhe viruseve. ITUN Vlorë gjatë fazës së operimit ka paraqitur probleme si pasojë e faktit që nuk është projektuar, llogaritur e zbatuar për një rrjet të kombinuar të ujërave të bardha me atë të ujërave të zeza, siç edhe është faktikisht rrjeti i kanalizimeve të qytetit të Vlorës. Kjo pasi komunikimet me përfituesin final të projektit, Ujësjiellës Kanalizime SHA. Vlorë janë zhvilluar vetëm në fazën operacionale, pra kur ka përfunduar ndërtimi i impiantit. Çështja më problematike mbetet qëndrueshmëria e projektit, pasi Koordinatori IPA, pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës Kanalizimeve, ka refuzuar fondin shtesë prej 3.4 milion Euro të ofruar nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri për të siguruar qëndrueshmërinë e projektit. Nga ana tjetër Qeveria Shqiptare nuk ka siguruar që institucionet përfituese të projektit “Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II” të kenë burime të përshtatshme financiare, materiale dhe njerëzore, në mënyrë që ndihma financiare e BE-së të përdoret në mënyrën më efektive. Vetë institucionet përfituese Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Koordinatori IPA (AKUM) dhe përfituesit final Bashkia Vlorë dhe

<sup>1</sup> ISSAI 400 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me pasqyrave financiare çështje të veçanta



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

Ujësjetllës Kanalizime SHA Vlorë, nuk kanë ndërmarrë masat e kërkuara për adresimin e qëndrueshmërisë së projektit. Pasi institucionet përfituese kanë dështuar në realizimin e kërkesave të delegacionit për hartimin e një plani veprimi, ngritjen e mekanizmave të kompetenca të përbashkëta dhe koordinuese të projektit, mungesës së kontratës së performancës së vitit 2019 si dhe mungesës së një marrëveshje opermi midis Bashkisë Vlorë dhe AKUM. Në këto kushte Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, në tetor 2018, ka ndërprerë pagesat për projektin e ndërtimit të sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Faza II, pjesë e IPA 2012 për mangësi serioze në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të programit të cilat ndikojnë në besueshmërinë e procedurave për certifikimin e pagesave dhe për të cilat nuk janë marrë masa korrigjuese. Nga auditimi ka rezultuar se këto pagesa vazhdojnë të mbeten të pezulluara dhe se Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktive (CFCU) ka paguar kontraktorët për pjesën e mbetur të punimeve me fonde të marra nga buxheti i shtetit, me zballancim të shpenzimeve buxhetore me burim financimi donatorët e huaj. Nga auditimi u konstatua gjithashtu se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet shuma prej **156,557 €** si pasojë e negociimit të çmimeve për zëra të rinj jashtë preventivit në kundërshtim me kushtet e kontratës.

**Shënim:** Të gjithë punonjësve që atakohen në këtë Raport Përfundimtar Auditimi duhet t’u bëhen prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË/CFCU PËR FONDET IPA 2012, PROJEKTI “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMIT NË VLORË , FAZA II”**

## **SHKURTIME**

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>CFCU</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve (për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë)
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>KE</b>	Këshilli Evropian
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>IFAC</b>	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>SHA</b>	Shoqëri Aksionare
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
<b>OE</b>	Operator Ekonomik
<b>KA</b>	Këshilli Administrativ
<b>KKRR</b>	Këshilli Kombëtar Rregullator